




Funded by
the European Union

Monitorimi i prokurimit publik në katër komuna: Gjakovë, Gjilan, Podujevë dhe Mitrovicë e Jugut

Dhjetor, 2021





SUNDIMI I LIGJIT

AUTORË:

Arbelina Dedushaj
Egzona Kozhani
Ardit Dragusha



Vizito webfaqen tonë
www.dplus.org

Mësoni më shumë rreth publikimeve tona të fundit,
lajmeve dhe infografikave online.



Find us on Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Find us on Facebook
[@democracy-plus](https://www.facebook.com/democracy-plus)



Find us on Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Find us on Youtube
[@Democracy-Plus](https://www.youtube.com/Democracy-Plus)

Zyra Jonë:

Rruga Tirana Blloku C/4/1, Hyrja C,
Kati VIII, Nr. 83/84
Prishtinë 10000, Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus-ks.org

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në çfarëdo forme ose me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjues ose tjera, pa lejen e D+.

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Demokraci Plus (D+) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Projekti "Kontribut në gjetjen e shkeljeve në prokurim publik të institucioneve në luftën kundër pandemisë COVID-19" i financuar nga BE, implementohet nga Demokraci Plus (D+).



Funded by
the European Union



Përmbajtja

SHKURTESAT	6
PËRMBLEDHJE E TË G-JETURAVE.....	7
KOMUNA E G-JAKOVËS	9
1. Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni.....	9
2. Furnizim me kompjuterë dhe laptopë	12
3. Dezinfektimi emergjent i gjitha objekteve dhe hapësirave publike	13
4. Sanimi – ndërtimi i rrugëve me asfalt.....	15
5. Mirëmbajtja e linjës së ndriçimit publik.....	16
6. Ndërtimi i shtratit të lumit Gusha në fshatin Batushë.....	17
KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT.....	19
7. Furnizimi dhe montimi i serrave të tipit tunel.....	19
8. Ndërtimi i infrastrukturës në Lagjen e Re në fshatin Frashër.....	20
9. Dezinfektimi emergjent i hapësirës së disa objekteve shkollore	21
10. Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të komunës dhe institucioneve tjera komunale	23
11. Furnizim me material higjieniko-sanitar për komunë, shkolla dhe institucione tjera komunale	24
12. Furnizim i shkollave me lëndë djegëse -dru- për ngrohje dhe institucione tjera komunale	26
KOMUNA E G-JILANIT.....	28
13. Mbushja me dezinfektantë dhe mirëmbajtja e tyre	28
14. Furnizim me maska dhe material dezinfektues	29
15. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative për Drejtorinë e Arsimit	30
16. Mirëmbajtja verore e rrugëve në Komunën e Gjilanit.....	31
17. Furnizim me veshmbathje për punëtorët e Komunës së Gjilanit	33
18. Ndërtimi i Tregut të Gjelbër në Komunën e Gjilanit	34
KOMUNA E PODUJEVËS.....	42
19. Renovimi i bibliotekës së qytetit	42
20. Furnizimi dhe montimi i serrave për fermerë.....	44
21. Riparimi i rrugëve të asfaltuara	45
22. Renovimi i hyrjeve dhe korridoreve të objekteve banesore në qytet	48
23. Furnizimi me material anti-covid – dezinfektues për duar	49
24. Meremetimi i hyrjeve të objekteve banesore	50
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	52

Shkurtesat

AK →	Autoriteti Kontraktues
AKK →	Agjencia Kundër Korrupsionit
ARBK →	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
ASK →	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK →	Administrata Tatimore e Kosovës
DT →	Dosja e Tenderit
GEO →	Grupi i Operatorëve Ekonomikë
KRPP →	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP →	Ligji për Prokurimin Publik
OE →	Operatori Ekonomik
OSHP →	Organi Shqyrtues i Prokurimit
RrUOPP →	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik

Përmbledhje e të gjeturave

Të përgjithshme për komunat subjekt të këtij raporti:

- Është përdorur procedurë e negociuar e prokurimit publik në kundërshtim me Ligjin për prokurim publik (LPP);
- Gjatë përdorimit të procedurës së negociuar ka pasur tendencë për të ftuar numër të vogël të operatorëve ekonomikë duke kufizuar konkurrencën;
- Në disa raste ka vazhduar shpallja fitues e operatorëve ekonomik edhe pse të njëjtit janë vlerësuar të pa papërgjegjshëm. Në të njëjtën kohë, këto komuna nuk kanë refuzuar ofertat e disa operatorëve ekonomikë të cilët kanë bashkëngjitur dokumente jovalide;
- Ka pasur mangësi në menaxhimin e zbatimit të kontratave, e për pasojë janë shkaktuar vonesa në realizimin e projekteve në interes të përgjithshëm;
- Në të shumtën e rasteve nuk praktikohet masa sanksionuese ndaj operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm në realizim të kontratave;
- Në disa raste është kërkuar ISO certifikata e një shteti specifik dhe shpesh herë janë kërkuar certifikata që janë jashtë funksionit, në kundërshtim me rregullin e përcaktuar me LPP.

Të veçanta:

Komuna e Gjakovës:

- Në tenderin “Sanimi dhe ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni“, komuna nuk ka konfiskuar sigurimin e ekzekutimit për grupin e operatorëve ekonomik fitues. Ky konsorcium nuk i kishte sjellë dokumentet që kërkohen pasi një operator ekonomik shpallet fitues;
- Komuna ka parashtruar kërkesë teknike në dosjen e tenderit në kundërshtim me LPP-në, duke kërkuar një standard të një shteti specifik. Në këtë mënyrë është kufizuar konkurrenca dhe janë diskriminuar operatorët e tjerë ekonomik;
- Në tenderin “Furnizim me kompjuterë dhe laptopë“, komuna ka qenë neglizhente në përpilimin e kërkesave teknike dhe si pasojë e gabimeve, ka dështuar realizimi i kontratës. Komuna ka kërkuar që furnizimi të bëhet me emër specifik të markës së prodhuesit, gjë që nuk është e lejuar pasi kufizon konkurrencën;
- Në tenderin “Ndërtimi i shtratit të lumit Gusha në fshatin Batushë“, komuna nuk ka bërë asnjë pagesë, pa varësisht faktit se kontrata është lidhur në vitin 2020 dhe punimet ishin planifikuar që të kryheshin brenda 30 ditëve nga dita nënshkrimit të kontratës;
- Në tenderin “Sanimi – ndërtimi i rrugëve me asfalt“, nuk është parashtruar asnjë kërkesë nga komuna për gjendjen financiare të operatorit ekonomik. Për shkak të vlerës së lartë të kontratës, mospërcaktimi i disa kërkesave ndikon në mënyrën e zbatimit të kontratës.

Komuna e Gjilanit:

- Në tenderin “Mirëmbajtja verore e rrugëve në Komunën e Gjilanit” është paraparë vlera vetëm për një vit, e jo për 36 muaj sa do të zgjasë kontrata kornizë, gjë që mund t’i shpie në lajthitje operatorët ekonomikë që ofertojnë për këtë tender;
- Në tenderin “Ndërtimi i Tregut të Gjelbër” komuna ka iniciuar kundërligjshëm procedurë të negociuar për lidhje të kontratës së dytë. Si rezultat i keqmenaxhimit të kontratës së parë për ndërtimin e këtij tregu, ka reflektuar në dhënien e kontratës së dytë për të njëjtat punë.

Komuna e Podujevës:

- Në tenderin “Renovimi i bibliotekës së qytetit”, si rezultat i keqmenaxhimit nuk është realizuar projekti në afatin e paraparë me kontratë, duke i tejzgjatur punimet;
- Në tenderin “Furnizim me material anti covid – dezinfektues për duar”, komuna nuk ka përcaktuar siç duhet se në çfarë sasive të bëhet furnizimi, gjë që mund të pasohet me probleme gjatë implementimit të kontratës;
- Në tenderin “Riparimi i rrugëve të asfaltuara” komuna ka lidhur kontratë me operatorin ekonomik i cili në një pozicion të paramasës kishte paraqitur çmim jonormalisht të ulët, e për të cilin komuna nuk kishte kërkuar sqarime shtesë;
- Në tenderin “Furnizim dhe montim të serrave për fermerë” komuna nuk ka marrë masa ndëshkuese ndaj operatorit ekonomik i cili ka shkelur afatin për përmbushje të kontratës.

Komuna e Mitrovicës së Jugut:

- Në tenderin “Furnizimi dhe montimi i serrave të tipit tunel” komuna gjatë zbatimit të kontratës ka bërë një pagesë disa ditë para se të fillojë implementimi i kontratës, gjë që ka hyrë në rrezik të dëmit financiar nëse nuk do të realizohej furnizimi siç duhet. Po ashtu, te kërkesat për mundësi teknike dhe profesionale, komuna ka përcaktuar numrin e kontratave të realizuara, në vend që të përcaktohet vetëm vlera e kontratave të realizuara;
- Në tenderin “Ndërtimi i infrastrukturës në Lagjen e Re në fshatin Frashër” komuna ka tejkaluar vlerën e parashikuar prej 36,000 euro, gjë e cila tregon për mungesë të planifikimit me kohë të prokurimit. Po ashtu, është eliminuar një operator ekonomik duke qenë se ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta, mirëpo komuna nuk ka kërkuar fare sqarime shtesë ashtu siç e kërkon LPP;
- Në tenderin “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të komunës dhe institucioneve tjera komunale”, komuna gjatë inicimit të aktivitetit të prokurimit ka ngatërruar kriterin e çmimit më të lirë dhe kriterin e çmimit ekonomikisht më të favorshëm;
- Në tenderin “Furnizim të shkollave dhe institucioneve të tjera komunale me lëndë djegëse – dru” komuna ka shkurtuar afatin e dorëzimit të ofertave pa publikim të njoftimit paraprak në kundërshtim me LPP. Po ashtu, komuna ka pranuar për të njëjtin tender si referencë, kontrata të papërfunduara, në kundërshtim me LPP.



Komuna e Gjakovës

1. Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve me kubëza betoni

Komuna e Gjakovës, në prill të vitit 2020, publikoi tenderin për sanimin e rrugëve me kubëza betoni me një buxhet prej 700,000.00 euro. Në këtë tender kanë marrë pjesë gjashtë operatorë ekonomik (OE), ku me kontratë u shpërblye kompania NTP Fidani-L me çmim prej 626,653.15 euro. Por, siç vërehet nga tabela më poshtë, oferta e NTP Fidani-L ishte njëra prej më të shtrenjtave, e dyta për nga çmimi më i lartë.

Tabela 1 – Çmimet e ofertave të operatorëve ekonomik

Nr.	Tenderuesi	Çmimi në EURO
1	Udha Sh.P.K & Fidani Beton Sh.P.K.	575,474.55
2	Stublla Sh.P.K.	649,099.20
3	Seticommerce Sh.P.K & Construmax Sh.P.K.	568,336.43
4	Ramë Haklaj B.I.	600,000.00
5	NTP Fidani-L	626,653.15
6	Liqeni VII	622,138.10

Mirëpo, Komuna e Gjakovës fillimisht ka shpallë fitues konsorciumin Udha Sh.P.K. & Fidani Beton Sh.P.K. Sipas Dosjes së Tenderit të analizuar nga D+, para nënshkrimit të kontratës, dy anëtarët e konsorciumit kanë qenë të obliguar t'i dorëzojnë këto dokumente:

¹ Platforma e-prokurimi, njoftimi për nënshkrimin e kontratës: <https://bit.ly/3DSW1fr>

- Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) që dëshmon që OE nuk është në vonesë të pagesave të tatimeve deri në tremujorin e fundit para aplikimit për tender;
- vërtetimin nga gjykata kompetente se OE nuk është i falimentuar ose i likuiduar;
- vërtetimin nga komuna që OE nuk ka obligime të tatimit në pronë; dhe
- sigurimin e tenderit në origjinal.

Këto dokumente janë kërkuar nga ana e komunës më 1 korrik 2020, duke i dhënë konsorciumit pesë ditë kohë për t'i dërguar. Konsorciumi nuk ka dërguar asnjë dokument, me ç'rast edhe është eliminuar. Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP)², nëse një ofertues shpallet fitues, por dështon t'i dorëzojë certifikatat e kërkuara, atëherë vazhdohet me ofertuesin e dytë. Përveç këtij veprimi, autoriteti kontraktues (komuna në këtë rast) duhet edhe ta konfiskojë sigurinë e tenderit si dhe ta iniciojë procedurën për diskualifikimin e OE sipas nenit 99.2 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Diskualifikimi mund të zgjasë deri në një vit, gjatë të cilës kohë operatori ekonomik nuk ka të drejtë të marrë pjesë në tenderë dhe të fitojë kontrata publike. Këtë vendim e merr Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), pas kërkesës që paraqitet nga autoriteti kontraktues. Në këtë rast, Komuna e Gjakovës si autoritet kontraktues ka bërë kërkesë në OSHP që konsorciumi Udha Sh.P.K. dhe Fidani Beton Sh.P.K. të diskualifikohen.

Komuna e Gjakovës kishte vazhduar me ofertuesin e dytë të përgjegjshëm, NTP Fidani-L, i cili kishte ofertën për 51,178.60 euro më të shtrenjtë (oferta në total: 626,653.15). Nga ana tjetër, të gjitha ofertat tjera janë vlerësuar si të papërgjegjshme, për shkak të mospërbushjes së kriterëve.

Mirëpo, sipas hulumtimit të D+, NPT Fidani-L dhe anëtari i konsorciumit i shpallur fillimisht fitues, Fidani Beton Sh.P.K. kanë shumë elemente të përbashkëta. Të dy kompanitë kanë:

- Adresë të njëjtë të dhënë në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK);
- menaxher të njëjtë, i cili ka nënshkruar për stafin sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit;
- numër të njëjtë të telefonit, dhe
- ueb-faqja e Fidani Beton Sh.P.K. e dhënë në Facebook të dërgon te faqja e fituesit të dytë: www.fidaniil.com

Të gjitha këto të dhëna tregojnë që bëhet fjalë për të njëjtën kompani. Komuna kështu ka lejuar që tenderi të kurdiset dhe të paguajë mbi 50,000.00 euro më shumë sesa që do paguante po të nënshkruhej kontrata me fituesin e parë. Në rastet kur OE-të shpallen fitues dhe tërhiqen nga nënshkrimi i kontratës, i vetmi mjet mbrojtës për komunën është konfiskimi i sigurisë së tenderit, si dhe kërkesa për futjen në Listë të Zezë. Në këtë rast, sigurimi i tenderit ka qenë 20,000.00 euro, shumë e cila nuk është konfiskuar.

Siç u cekë më lart, kompanitë tjera janë cilësuar të papërgjegjshme. Kjo ka ndodhur pasi të katër ofertuesit tjerë nuk kanë dorëzuar ISO DS CEN TR 15128 2015, i cili është një standard për rehabilitimin e sistemit të kullimit (drenazhim-it) dhe kanalizimeve. Kjo kërkesë është shtuar përmes “njoftimit për korrigjim të gabimeve”, 10 ditë pasi është publikuar Dosja e Tenderit³. Mirëpo, shkelja që ka bërë Komuna e Gjakovës shkon edhe më tutje; standardi ISO DS CEN TR 15128 2015 është tërhequr, pra nuk është aktiv prej datës 15 shkurt 2016⁴. Në Dosje të Tenderit është shënuar që ky standard është i vitit 2015, mirëpo në realitet ky është standard i vitit 2005. E gjetur tjetër është që ky standard është i shtetit të Danimarkës dhe sipas Ligjit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të kërkojë standard të një shteti specifik: *“autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që zbaton një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evro-*

2 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, Neni 26.8, faqe 65: <https://bit.ly/3ygELji>

3 Dokument i siguruar nga D+ pas kërkesës për qasje në dokumente publike.

4 Shih Standardin Dansk (Dansk Standard) ku është shënuar *Tërhequr* (ang. Withdrawn): <https://bit.ly/3mgkNjH>

pian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim”⁵.

Të dy kompanitë (ajo fituese në rastin e parë e cila është diskualifikuar pastaj, si dhe kompania e shpallur fituese herën e dytë – NTP Fidani-L) janë certifikuar me këtë standard nga një kompani ndërkombëtare⁶, mirëpo vegëza⁷ që vërteton validitetin e certifikatës, nuk funksionon. Pra, ekziston dyshimi që kompanitë Fidani Beton Sh.P.K. dhe NTP Fidani-L nuk janë të certifikuara për këtë standard.

Komuna ka bërë shkelje edhe gjatë vlerësimit të ofertës së kompanisë Fidani-L. Në Dosje të Tenderit është kërkuar që ofertuesi të ketë dëshmi që ka përfunduar projekte të ngjashme në vlerë prej një milion euro në tri vitet e fundit. Kompania Fidani-L ka shënuar në listë që ka përfunduar katër kontrata, të cilat kanë vlerë mbi 1.35 milion euro, mirëpo, njëra nga referencat e bashkangjitura është kontratë e papërfunduar. Sipas interpretimit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), kontrata duhet të jetë e përfunduar e jo kontratë që është në realizim e sipër⁸.

Një shkelje tjetër e kritereve të caktuara nga komuna ka të bëjë me regjistrimin e automjeteve. Kërkesa e komunës ka qenë që tre kamionë të jenë me regjistrim valid. Në këtë drejtim, kompania Fidani-L ka ofruar pesë kamionë, ku në bazë të hulumtimit të tërë dokumentacionit të tenderit, del që të gjithë kamionët janë me regjistrim të skaduar. Duhet shtuar se në periudhën kur pandemia COVID-19 ka filluar edhe në Kosovë, është lejuar që të qarkullohet vetëm me policën e sigurimit të automjetit, mirëpo pas datës 18 maj 2020⁹, janë hapur përsëri qendrat e regjistrimit. Oferta e Fidani-L është dorëzuar më 12 qershor 2020, gjë që do të thotë se vendimi për qarkullim vetëm me policën e sigurimit nuk ka qenë më valid. Pra, as kjo kërkesë nuk është plotësuar nga kompania Fidani-L, për çka edhe është dashur të eliminohet.

Problem tjetër i evidentuar është edhe çështja e punëve që do të kryhen sipas kontratës. Më shumë se gjysma e kontratës është paraparë të shpenzohet vetëm për pagesë të pozicionit të parë të paramasës, e që është “Incizimi dhe verifikimi gjeodezik i konturave të trasesë së rrugës, trotuareve dhe shesheve”¹⁰.

Për këtë shërbim, komuna do të paguajë 372,960.00 euro apo 18.50 euro për metër katror. Vetëm konsorciumi i shpallur fillimisht fitues, Udha Sh.P.K. & Fidani Beton Sh.P.K. ka çmim të përafërt, me 16.50 euro për metër katror. Çmimi dallon drastikisht te ofertuesit tjerë, Stublla Sh.P.K., operator i cili ka ofertuar për këtë shërbim me 0.20 euro, Seticommerce Sh.P.K. & Construmax Sh.P.K. me 0.15 euro, ndërsa Liqeni VII akoma më lirë, për vetëm 0.02 euro.

Për këtë kontratë është nënshkruar edhe një aneks kontratë¹¹ me kompaninë Fidani-L në vlerë 31,930.13 euro, kontratë në të cilën për pozicionin e njëjtë “incizimi dhe verifikimi gjeodezik i konturave të trasesë së rrugës trotuareve dhe shesheve” është planifikuar të shpenzohen edhe 28,039.53 euro. Komuna në fund të kontratës do të paguajë mbi 400,000.00 euro vetëm për incizim gjeodezik, ku çmimi i tregut për këtë shërbim është një euro për metër katror¹². Kjo ofertë është dashur të refuzohet në bazë të nenit 4.2c të udhëzuesit¹³, i cili thekson që çmimi i kontraktuar nuk do të jetë më i lartë se çmimi i tregut.

5 Ligji nr. 04/-042 për Prokurimin Publik, Neni 24, paragrafi 8: <https://bit.ly/3rY4OKU>

6 Kompania ndërkombëtare quhet: EAS International: <http://www.eas-intl.com/>

7 Vegëza (linku) në fjalë i cili nuk është valid apo nuk funksionon: <https://bit.ly/320kumt>

8 Interpretimi i KRPP-së: <https://bit.ly/3shrCoX>

9 Epoka e re <https://bit.ly/3pmjG3V>

10 Në çmim duhet të kalkulohet edhe incizimi i tërësishëm gjeodezik i konturave të trasesë së rrugës, trotuareve dhe shesheve i cili duhet pas përfundimit të punimeve t'i dorëzohet organit mbikëqyrës në mënyrë elektronike.

11 Aneks kontrata gjendet në: <https://bit.ly/3E9hllj>

12 Raporti i Auditimit për Komunën e Gjakovës, 2020, fq.11 <https://bit.ly/3J41wMe>

13 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik <https://bit.ly/3ySJRIU>

Gjatë zbatimit të kontratës, komuna ka shkelur sërish LPP-në. Në bazë të faturave që ka siguruar D+, komuna ka paguar 624,648.85 euro, ku vetëm për shërbimin e incizimit të rrugës ka paguar 501,210.91 euro sipas kontratës bazë. Pasi të shtohen edhe 28,039.53 euro të aneks kontratës, totali i këtij pozicioni do të jetë 529,250.44 euro. Kjo është një shkelje e rëndë e ligjit, pasi kontrata nuk është e llojit kontratë kornizë dhe komuna nuk ka pasur të drejtë që ta tejkalojë vlerën për secilin shërbim. Nëse merret parasysh ky çmim kaq i lartë i dhënë vetëm për incizim dhe verifikim gjeodezik, atëherë komuna ka paguar fare pak për të shtruar kubëza. Në fakt, kubëzat kanë mundur të shtrohen edhe pa këtë shërbim, siç kanë bërë shumë autoritete tjera kontraktuese. Me këtë veprim, komuna i ka shkaktuar dëm buxhetit të saj për rreth 530,000.00 euro. Kontrata është dashur të ndërpritet në momentin që është shpenzuar vlera e kontratës për këtë shërbim, ku si pasojë e tejkallimit të vlerës, shumë pozicione me çmim të ulët kanë mbetur pa u porositur fare.

Si përfundim, Komuna e Gjakovës përveç që ka përshtatur kriteret për kompani të caktuara duke kërkuar një certifikatë ISO për një standard i cili nuk ka qenë në fuqi, në fund ka lejuar që të kurdiset tenderi, në mënyrë që ta fitojë kontratën operatori ekonomik më i shtrenjtë. Komuna nuk ka tentuar fare që ta zvogëlojë humbjen në buxhet, duke mos e konfiskuar sigurinë e tenderit dhe duke mos bërë kërkesë që Udha Sh.P.K. dhe Fidani Beton Sh.P.K. të futen në Listë të Zezë.

2. Furnizim me kompjuterë dhe laptopë

Një kontratë tjetër e analizuar është ajo për furnizim me kompjuterë dhe laptopë për shkolla. Komuna e Gjakovës e ka ndarë këtë tenderë në tre lloje, përkatësisht një llot për furnizim me kompjuterë, një për projektorë dhe një për TV. Vlera e parashikuar e tenderit ishte 110,555.00 euro. Për furnizim me TV ofertuan shtatë kompani, ndërsa fitues është zgjedhur kompania Panamic ICT me çmim 21,375.00 euro. Për këtë llot ka pasur dy herë ankesa në OShP nga dy kompani tjera. Të dy këto kompani ishin eliminuar nga komuna për shkak se ofertuan me TV me madhësi më të madhe sesa që është kërkuar. Mirëpo, kompania e parë ankuese, Mediatech & Print, në ankesën e saj, ka pretenduar¹⁴ se TV i ofruar nga Panamic ICT është markë shumë e dobët dhe nuk mund të gjendet fare përmes kërkimit në internet. Edhe pse tenderi dy herë është rikthyer në rivlerësim, komuna përsëri shpalli fitues Panamic ICT¹⁵.

Sidoqoftë, Komuna e Gjakovës më 3 gusht 2021, ka shkëputur kontratën me Panamic ICT me arsyen se nuk janë sjellë TV sipas specifikave teknike që janë kërkuar. Edhe pse komuna i ka dhënë mundësi tre herë kompanisë që të dërgojë produktet siç janë kërkuar, ajo ka dështuar ta bëjë këtë. Ky dështim në furnizim ka ardhur si pasojë e disa gabimeve dhe neglizhencës që AK ka bërë karshi ofertës së Panamic ICT.

Panamic ICT ka ofertuar me modelin Ecolux EC55T2. Gabimi i parë është se komuna nuk ka kërkuar katalog për këtë llot (ka kërkuar vetëm për llot 1 ku janë të përfshirë laptopët). Megjithatë, Panamic ICT ka ofruar një “katalog” të cilin e ka krijuar vetë, pasi nuk ka fare logo të prodhuesit dhe as dizajn profesional, në krahasim me katalogjet që janë dorëzuar nga ofertuesë tjerë. Pra, mospërputhja e specifikave teknike ka mundur të vërehet në fillim. Komuna ka kërkuar që TV të jetë Smart TV, ndërsa modeli i ofruar nga Panamic ICT nuk është “smart”. Kompania gjatë zbatimit të kontratës ka tentuar që të “mashtrrojë” komunën duke ofruar TV dhe një Android Box si ekuivalent. Pastaj, sipas katalogut të dorëzuar, në të shkruan që rezolucioni i TV është Full HD (1920x me 1080), derisa komuna kishte kërkuar 4K (3840 me 2160). Komuna po ashtu kishte kërkuar që TV të posedojnë “bluetooth”, të cilin element apo karakteristikë nuk e ka modeli i Ecolux¹⁶. Sikur këto elemente t'i vërente komisioni i vlerësimit të ofertave, nuk do të vinte deri te ndërprerja e kontratës, e shkollat nuk do të mbetnin pa TV, në kohën kur veçse kishte filluar viti shkollor.

¹⁴ Ankesa e OE Mediatech & Print: <https://bit.ly/3yZtunJ>

¹⁵ Kontrata është nënshkruar më 18 mars 2021.

¹⁶ Shih karakteristikat e modelit Ecolux: <https://bit.ly/3sfk6ep>

Kontratën për furnizim me projektor, e fitoi gjithashtu Panamic ICT me çmim 3,050.00 euro, mirëpo oferta e Panamic ICT është 3,986.00 euro. Ky mund të jetë një gabim teknik në kontratë, megjithatë komuna duhet të sigurohet që nuk ka gabime të tilla pasi mund të ketë probleme gjatë pagesave.

Pastaj, në specifikat teknike janë përmendur emra specifik të produkteve, gjë që nuk është e lejuar me legjislacionin e prokurimit. Emri i produktit mund të përmendet vetëm në ato raste kur vije pas fjala "ekuivalente". Komuna ka kërkuar modelin e projektorit EH-TW650, që është i prodhuesit Epson. Si pasojë e kësaj, vetëm kompanitë që kanë ofertuar me këtë lloj projektori kanë mundur t'i plotësojnë specifikat teknike. Përmendja e emrit të produktit pa shtuar fjalën ekuivalente ngritë dyshimin për kurdisje të tenderit.

Për kontratën për furnizim me laptopë, AK ka shpallur fitues kompanin Kibernetika Sh.P.K. me çmim 80,615.00 euro. Fillimisht fitues ishte shpallur OE Aritech, me çmim 78,922.00 euro, i cili nuk i ishte përgjigjur ftesës për nënshkrim të kontratës. Njëjtë si për specifikat teknike për projektorë, edhe në këtë rast, komuna ka hartuar specifikat e kompjuterëve duke përmendur specifikisht produktet e prodhuesit Intel, pa shtuar fjalën ekuivalente. Në tregun e kompjuterëve ka edhe kompani tjera që prodhojnë procesorë dhe që kanë shpejtësi ekuivalente me ato të Intel.

Afati për dorëzimin e produkteve sipas Dosjes së Tenderit ishte 30 ditë. Megjithatë, në bazë të faturave vërehet që disa produkte, në momentin e analizimit të tenderit, nuk janë dorëzuar edhe pse kontrata është nënshkruar në dhjetor të vitit 2020.

3. Dezinfektimi emergjent i gjitha objekteve dhe hapësirave publike

Tenderi për dezinfektim emergjent të të gjitha objekteve dhe hapësirave publike është zhvilluar përmes procedurës së hapur, ku ofertuan tre operatorë ekonomikë. Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 60,000.00 euro, ndërsa me këtë kontratë kornizë në kohëzgjatje prej 12 muajsh është shpërblyer kompania Truly Nolen Sh.P.K. me çmim 51,337.50 euro. Me çmim më të lirë kishte ofertuar konsorciumi Haki Bytyci B.I. & Safet Osmani B.I., me 28,257.50 euro, i cili ishte eliminuar për shkak të mosdorëzimit të dëshmimeve për pesë punëtorë të certifikuar për përdorimin e preparateve.

Tabela 2- Çmimet e ofertave të operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik	Çmimi
Truly Nolen Sh.P.K.	51,337.50 euro
Haki Bytyci B.I & Safet Osmani B.I.	28,257.20 euro
Oni shpk & Fatos Lashi Egian	53,180.00 euro

Për shkak të natyrës së ndjeshme të shërbimit, Komuna e Gjakovës ka parashtruar një sërë kërkesash ndaj operatorit. Në mesin e kërkesave, komuna ka kërkuar nga operatori ekonomik licencën OHSAS 18001:2008¹⁷. Ky standard është standard britanez i cili më nuk përdoret dhe i njëjti është zëvendësuar me standardin ISO 45001¹⁸ nga

17 Standardi OHSAS 18001: <https://bit.ly/3J6NHgb>

18 Standardi ISO 45001: <https://bit.ly/3Ep8Gr6>

viti 2018. Pavarësisht faktit se ky standard më nuk përdoret, komuna me këtë kërkesë ka shkelur LPP-në, i cili kërkon që të përdoren standarde evropiane dhe jo të ndonjë shteti specifik¹⁹. Pra, përcaktimi i specifikimeve teknike që i referohen një prodhim specifik, një procesi të veçantë, marke tregtare, patente, origjina specifike ose prodhime, është i ndaluar.

Sipas shembujve të komunave tjera, vërehet se ka rënë vlera e çmimit mesatar për kryerjen e këtyre shërbimeve në vitin 2021, si p.sh. Komuna e Prishtinës në qershor të vitit 2021 ka kryer këtë lloj shërbimi me çmim mesatar 0.08 euro, derisa Komuna e Suharekës në të njëjtën periudhë ka kryer këto shërbime me çmim mesatar 0.03 euro, ndërsa Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) në korrik të vitit 2021 me 0.12 euro. Përveç këtyre komunave, edhe ajo e Istogut, në po të njëjtën kohë, ka kryer këto shërbime me çmim mesatar për 0.05 euro. Kjo është tregues i qartë që çmimet në treg janë më të lira sesa ato që janë kontraktuar ndërmjet AK-së dhe OE-së fituese.

Po ashtu, në paramasën e ofertuar shohim se shërbimet për dezinfektim janë kërkuar në hapësira të ndryshme, si dezinfektimi për Qendën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF), Ambulancën e Mjekësisë Familjare (AMF), të gjitha objektet komunale, hyrjet e banesa kolektive dhe shtëpitë e paraqitura si raste. Për pozicionin e parë, kemi përafërsisht 35 tretmane ku edhe është vendosur çmimi më i lartë për dezinfektim të një metri katror, ndërsa, në pozicionin e tretë ku ka më së paku tretmane, është vendosur çmim më i ulët për dezinfektim të metrit katror.

Tabela 3 - Paramasa me çmime për kryerjen e dezinfektimit

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Tretmanet e përafërta	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	QKMF, QMF, AMF	m2	1330	35	0.25 euro	11,637.00 euro
2	Të gjitha objektet komunale	m2	3500	31	0.20 euro	21,700.00 euro
3	Hyrjet e ndërtesave kolektive dhe shtëpitë e paraqitura si raste	m2	20000	5	0.18 euro	18,000.00 euro
Gjithsej totali me TVSH						51,337.50 euro

Numrin për tretmane të përafërta e ka vendosur vetë komuna, element i cili ka qenë indikator për vendosjen e çmimit më të lartë dhe atij më të ulët. Mirëpo, pasi metri katror është njësoj sikurse për hyrje të ndërtesave ashtu edhe për objekte komunale e qendra të mjekësisë familjare, atëherë do të duhej që për metër katror të vendosej çmimi i njëjti në të tre pozicionet.

Në bazë të faturave të dërguara nga operatori ekonomik, deri tani janë shpenzuar 16,777.32 euro nga totali prej 51,337.50 euro. Nga 16,777.32 euro të shpenzuara, 5,963.00 euro kanë shkuar për dezinfektim të objekteve komunale dhe 10,814.32 euro për dezinfektim të QKMF, QMF dhe AMF. Ndërsa, nuk është bërë asnjë shpenzim për pozicionin e tretë, hyrjet e ndërtesave kolektive dhe shtëpitë e paraqitura si raste.

¹⁹ Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 28.

4. Sanimi – ndërtimi i rrugëve me asfalt

Në shkurt të këtij viti, Komuna e Gjakovës ka iniciuar aktivitetin e prokurimit për sanimin – ndërtimin e rrugëve me asfalt, punë kjo e parashikuar të kushtojë 834,946. 90 euro.

Komuna e Gjakovës, duke përdorur procedurën e negociuar, ka ftuar tri kompani që t'i dorëzonin ofertat e tyre. Nga tre operatorët ekonomikë, vetëm dy prej tyre kishin rezultuar të përgjegjshme, teksa tenderi i është dhënë ARFA GROUP Sh.P.K., më datë 17 mars 2021, si tenderi me çmimin më të ulët, në vlerë prej 838,998.44 euro.

Tabela 4 - Ofertat e OE të ftuar nga Komuna e Gjakovës për tenderin Sanimi – ndërtimi i rrugëve me asfalt

Nr.	Operatori ekonomik	Oferta
1	VIA Sh.P.K.	847,933.44 euro
2	BERISHA COM Sh.P.K.	839,692.57 euro
3	ARFA GROUP Sh.P.K.	838,998.86 euro

Komuna e Gjakovës ka përdorur procedurën e negociuar, me arsyetimin se rrugët lokale kishin gjendje jo të mirë. Sipas vlerësimit të Sektorit të Komunikacionit²⁰, në gjendje jo të mirë ishin edhe rrugët kryesore.

AK ishte bazuar në nenin 35 të LPP-së, i cili lejon mundësinë e kontraktimeve të tilla, pa aplikuar procedura standarde të prokurimit. Në rastet kur është e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme, që janë shkaktuar nga ngjarje objektivist të verifikueshme, e të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues. Arsyetimi i komunës për përdorimin e procedurës së negociuar nuk qëndron, pasi dëmtimi i rrugëve nga reshjet atmosferike dhe hedhjes së kripës gjatë stinës së dimrit, nuk është nevojë emergjente²¹, duke qenë se një gjë e tillë është lehtë e verifikueshme.

Për më tepër, Komuna e Gjakovës kishte planifikuar këtë tender në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin fiskal 2021²², duke parashikuar shumë prej 800 mijë euro. Në këtë mënyrë, Komuna e Gjakovës ka cenuar të drejtën e operatorëve tjerë ekonomikë duke mos e përdorur procedurën e hapur.

Përdorimi i procedurës së negociuar nuk është arsyetuar mjaftueshëm nga Komuna e Gjakovës dhe e njëjta është dashur që të sigurojë pjesëmarrje sa më të gjerë të mundshme të operatorëve ekonomikë të interesuar²³, në mënyrë që të sigurohet konkurrenca.

Komuna e Gjakovës nuk ka përmendur asnjë kërkesë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare²⁴ të OE, kriter ky i cili është në diskrecion të autoriteti kontraktues, por duke qenë se bëhet fjalë për tender të vlerës së madhe, do të ishte e preferueshme të specifikohet qarkullimi minimal²⁵, me qëllim që të bëhet një vlerësim më i saktë i stabilitetit financiar dhe ekonomik të ofertuesëve.

20 Kërkesa për veprim emergjent e datës 02.02.2021 nga Sektori i Rrugëve Lokale dhe Sektori i Komunikacionit për kryetarin e Komunës së Gjakovës, z.Ardian Gjini.

21 Ligji për Prokurim Publik, neni 35 pika 2.1.

22 Planifikimin Përfundimtar i Prokurimit të Komunës së Gjakovës për vitin 2021

23 Po aty.

24 Dosja e Tenderit me nr. Prokurimi 632-21-396-5-1-5, pika 8.1

25 Ligji për Prokurim Publik, neni 68.

5. Mirëmbajtja e linjës së ndriçimit publik

Drejtoria e Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës, më 31 mars 2020, kishte kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të shpallë tenderin për “Mirëmbajtjen e linjës së ndriçimit publik”, me vlerë të parashikuar prej 200,000.00 euro për dy vite. Për këtë tender, Komuna e Gjakovës ka lidhur kontratë me operatorin Labinot M. Krasniqi B.I., e cila ka hyrë në fuqi më 02 korrik 2020 dhe përfundon më 02 korrik 2022. Meqenëse kemi të bëjmë me kontratë kornizë, kontrata është lidhur me vlerën totale indikative prej 122,826.00 euro, në të cilën aplikohet devijimi i lejuar prej +-30% nga vlera totale indikative. Sipas LPP-së, nëse vlera kalohet mbi devijimin e lejuar, atëherë kontrata ndërprehet në mënyrë automatike edhe në rastet kur vlera totale indikative kalohet nga një artikull apo pozicion. Ky operator ekonomik njëherësh ka qenë edhe operatori më i lirë që ka ofertuar për këtë tender.

Tabela 5 - Operatorët ekonomikë dhe vlerat totale e ofertave të tyre për këtë tender

Nr.	Emri i Operatorëve Ekonomikë	Vlera totale e ofertave
1	“BM GROUP” SH.P.K.	123,835.50 euro
2	Labinot M. Krasniqi B.I	122,826.00 euro
3	GOE SELMANS NETWORK SH.P.K. ; N.T PROTON	196,772.50 euro
4	Multi Business Group SH.P.K. JUSUF GËRVALLA	193,957.00 euro
5	N.M.I.Q MONTKOMERCE SH.P.K.	159,381.00 euro
6	GOE N.T.SH EING; Metush Hajdari B.I	145,240.00 euro

Zakonisht kur kemi të bëjmë me ndërtim të ndriçimit publik, në paramasë vendosen më shumë pozicione që kanë të bëjnë me ndërtim, siç mund të jenë gërmimet, vendosja e tokëzimit, vendosja e gypave të brinjëzuar, thyrje e prerje të betonit apo asfaltit, vendosja e shiritave vrojtues, vendosja e kabllove nëntokësore, instalime të tjera, etj. Ndërsa, te mirëmbajtja, në paramasë ka më shumë pozicione me shërbime që mundësojnë mirëmbajtjen, siç mund të jenë ndërrimi i ormanëve të vjetër me të rinj, pastrim dhe ngjyrosje të shtyllave elektrike, riparime të shtyllave të dëmtuara, ndërrimet e poçëve, ndërrimet e pajisjeve që ndikojnë në përçimin e rrymës elektrike, etj. Në paramasën e këtij tenderi, AK ka paraqitur pozicione që lidhen me mirëmbajtjen e ndriçimit për disa pozicione të tjera ngjajnë me tenderët që dedikohen për renovim (përmirësim) apo ndërtimin e ndriçimit publik.

Në njërin nga pozicionet që ngjanë më shumë me kryerje të punëve që lidhën me ndriçimin publik, komuna ka vendosur një sërë veprimtarish, për të cilat kishte vënë çmimin një euro.

Tabela 6 – Pozicioni i parë në paramasë

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	<p>Hapja e kanalit gjatësor (0.8 x 0.4)m, ku hyjnë të gjitha këto veprime të duhura.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Porosia dhe vendosja e rërës së imët me trashësi 10 cm nën kabull 10 cm mbi kabull -Porosia dhe montimi i gypave të brinjëzuar TIP PE 070 – 100mm - Porosia dhe vendosja e shiritit Fe Zn 25x4 mm për për tokëzim mbrojtësi tërhequr për gjatë gjithë trasesë e deri në shtyllë - Për tokëzimi i shtyllave, me shirit të për tokëzimit L=1.5m , i kyqur në për tokëzimin gjatësor me kryqëzues adekuat - porosia dhe vendosja e rërës së trash e vendosur vetëm në pjesën e grupuar - porosia dhe vendosja e shiritit vrojtues ne gjerësi prej 30 cm përgjatë gjithë trases, 20 cm nën kuaten e terrenit për ekzaminim të kablilit energjetik - porosia dhe vendosja e mbrojtësit “GALL” të vërehet mbi përcjellsin kabllovik - Ngjeshja e dheut 	m	2,000	1.00	2,000.00

Vendosja e pozicioneve të tilla, të cilat dihet që nuk do të porositen shumë, pasi veç ekzistojnë, mund të ketë ndikim në vlerësimin e ofertave. Duke e ditur këtë fakt, OE ka vendosur çmim të ulët në këtë pozicion, me ç’rast ka ulur vlerën totale të ofertës dhe është shpallur fitues. Ashtu siç edhe ka ndodhur, nga 70,486.15 euro të shpenzuara për vitin 2020 dhe vitin 2021, janë shpenzuar vetëm 81 euro për këtë pozicion. Ky tender është planifikuar të përfundojë në korrik të vitit 2022, ku sipas paramasës kanë mbetur edhe 1,919 gropime të tilla.

6. Ndërtimi i shtratit të lumit Gusha në fshatin Batushë

Komuna e Gjakovës, në shtator të vitit 2020, kishte iniciuar procedurën e tenderimit për ndërtim të shtratit të Lumit Gusha në Batushë. Të njëjtin e kishte anuluar, ku menjëherë në tetor 2020 kishte rishpallë tenderin për të njëjtën lëndë.

Për këtë tender vlera e parashikuar është përcaktuar të jetë 9,937.20 euro, në të cilin kanë ofertuar katër operatorë ekonomikë.

Tabela 7 - Operatorët ekonomikë që ofertuan në këtë tender

Operatorët ekonomikë	Oferta
OE N.P.N. Vizion-Plus	8,897.18 euro
OE N.T.Sh.T Viktory Com	17,978.74 euro
GOE TIMEPROJECT Sh.P.K. & Art – Konstruksion Sh.P.K.	9,713.55 euro
OE N.N.P. Vetoni	8,640.45 euro

Komuna e Gjakovës më 03 nëntor 2020 ka shpërblyer me kontratë GOE TIMEPROJECT Sh.P.K. & Art – Konstruksion Sh.P.K., si oferta e përgjegjshme, por për nga çmimi e treta më e lirë. Dy operatorët tjerë më të lirë janë eliminuar, ngase sipas komunës, nuk kanë plotësuar kërkesa për pajisje teknike të punës. Kjo kontratë është planifikuar të përmbushet brenda 30 ditëve.

Operatorët tjerë ekonomikë janë eliminuar për mospërmbushje të kërkesave teknike e profesionale, mirëpo edhe operatori ekonomik fitues ka disa defekte në plotësimin e këtyre kërkesave. Në Dosje të Tenderit është kërkuar që operatori të ketë pesë punëtorë, një inxhinier të ndërtimtarisë dhe një gjeodet. Për punëtorët, operatori ekonomik është dashur të ofrojë kontratën e punës ose lidhjen e kontratës mbi vepër, duke e cekur projektin në fjalë. Grupi i operatorëve ekonomikë i ka dorëzuar kontratat, CV-të dhe diplomat vetëm për inxhinierin e ndërtimtarisë dhe të gjeodetit, për këtë të fundit diploma nuk ka qenë e noterizuar. Komuna gjithashtu ka kërkuar që operatori ekonomik të sjellë një listë të mjeteve të punës si: një eskavator me strukturë rrotulluese me peshë mbi 10 tonë, dy kamionë me konstruksion ndërtim kiper me peshë mbi 10 tonë dhe një cilindër ngjeshës me peshë minimum katër tonë. Për këto mjete, operatori ekonomik është dashur të dëshmojë pronësinë e tyre apo marrjen me qira dhe të sjellë librezën e qarkullimit ose përmes dokumentit unik doganor (DUD). Sipas listës që GOE ka ofruar, dy kamionët i ka të regjistruar, mirëpo vetëm për njërin ka sjellë librezën e qarkullimit me afat valid, ndërsa për tjetrin nuk ka librezë të qarkullimit. Për cilindrin katër tonësh, ka sjellë dokumentin unik doganor, ndërsa për eskavatorin nuk ka sjellë ndonjë dokument.

Këto elemente e bëjnë grupin e operatorëve ekonomikë të papërgjegjshëm dhe oferta e tyre do të duhej të refuzohej si e papërgjegjshme.

Siç është cekur edhe më lart, tenderi është planifikuar të përfundohet brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, e cila ishte lidhur më 3 nëntor 2020. Mirëpo, as pas një viti nga lidhja e kontratës, Komuna e Gjakovës nuk ka kryer asnjë pagesë. Duke qenë se kontrata ishte lidhur në fund të vitit buxhetor dhe për shkak të mosimplementimit me kohë të kontratës, paratë e zotuara për këtë projekt janë kthyer si suficit buxhetor. Në këto raste janë dy opsione, që kontrata të ndërpritet nga komuna si autoritet kontraktues ose nga operatori ekonomik duke u thirru në nenet 11 dhe 12 të kontratës së nënshkruar mes tyre. Sipas nenit 11 të kontratës, “Autoriteti Kontraktues mundet që, pasi t’i japë OE shtatë ditë paralajmërim, ta ndërprerë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim a) Kur OE nuk arrin të i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar”. Apo, sipas nenit 12 të së njëjtës kontratë, Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse AK a) nuk arrin ti paguajë Operatorin Ekonomikë shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë”²⁶.

26 Sipas kontratës së nënshkruar në mes të autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik, nenet 11 dhe 12, e cila është pjesë e dosjes së tenderit siguruar nga D+.



Komuna e Mitrovicës së Jugut

7. Furnizimi dhe montimi i serrave të tipit tunel

Komuna e Mitrovicës së Jugut ka iniciuar procedurën për këtë tender në mars të vitit 2020, me vlerë të parashikuar prej 27,315.00 euro. Në këtë tender kanë ofertuar vetëm dy kompani, N.P.T. Agrobora dhe N.P.T. Eurosera & Berisha Construction Sh.P.K. Me kontratë ishte shpërblyer kompania N.P.T. Agrobora me çmimin më të lirë, 23,945.00 euro, derisa GOE Eurosera & Berisha Construction kishte ofertuar me çmim më të lartë, përkatësisht 24,950.00 euro. Pas kontratës bazë, është nënshkruar edhe një aneks kontratë me të cilën janë porositur edhe pesë (5) serra shtesë me çmim 2,394.50 euro, që reflekton 10% të vlerës së kontratës bazë.

Hartimi i kriterëve në Dosjen e Tenderit nuk është bërë në përputhje me LPP, gjë që ka mundur të ndikojë në zvogëlimin e numrit të ofertave. Komuna ka kërkuar që përvoja e punës për furnizime të tilla të dëshmohet përmes tri referencave dhe tri kontratave, por nuk ka specifikuar vlerën e tyre. Kërkesa do të duhej të ishte në atë mënyrë që ofertuesi të prezantojë referenca në një vlerë të caktuar, pra të mos kufizohet te numri i referencave, por të ceket vetëm vlera e kërkuar. Konkurrenca në këtë rast mund të dëmtohet shumë lehtë, pasi mund të ketë kompani që ka një apo dy referenca me vlerë shumë të madhe, e cila do të eliminohej nga ky tender pikërisht për shkak të këtij kushti. Nga ana tjetër, një kompani mund t'i ketë tri referenca, por me vlerë shumë të vogël, që do ta plotësonte si kusht dhe nuk do të eliminohej. Për AK-në, si më e rëndësishme duhet të jetë vlera e projekteve të realizuara sesa numri i kontratave. Disa opinione të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) kanë të bëjnë me këtë lloj kërkesë të autoriteteve kontraktuese, ku thuhet se nuk duhet të kërkohet numri i kontratave, por mjafton që të dorëzohet një listë e kontratave që mbulon shumën e kërkuar nga AK²⁷.

Sigurimi i tenderit është kërkuar të jetë valid për 90 ditë, mirëpo kompania N.P.T. Agrobora e ka ofruar atë vetëm për 60 ditë. Për këtë shkelje, oferta e N.P.T. Agrobora do të duhej të refuzohej. Për këtë çështje ka pasur pretendim ofertuesi i dytë, por ky OE, ankesën e tij, nuk e ka dorëzuar përmes platformës së e-Prokurimit dhe komuna me të drejtë e ka refuzuar si ankesë.

Sa i përket zbatimit të kontratës, vërehet që disa pagesa janë bërë para se të përfundojë furnizimi dhe të dorëzohet raporti i pranimit. Sipas kontratës, furnizimi ka filluar më 11 maj 2020 dhe ka përfunduar më 15 korrik 2020. Mirëpo,

²⁷ Agjencia Kundër Korrupsionit, Opinion i dhënë për Komunën e Gjilanit, tetor 2019: <https://bit.ly/3e31WnN>

komuna më 7 maj, disa ditë para se të fillonte furnizimi, ka paguar 10,000.00 euro. Në Kushtet e Veçanta të kontratës nuk është paraparë që të paguhet avans për operatorin ekonomik, ndërsa neni 26 i Kushteve të Përgjithshme të kontratës thotë se pagesat bëhen pas raporteve të aprovuara dhe të nënshkruara nga menaxheri i kontratës. Pra komuna ka paguar 10,000.00 euro ende pa filluar zbatimin e kontratës, duke rrezikuar kështu humbje për komunën në rast që nuk do të fillonte implementimi i kontratës për arsye të ndryshme. Përveç kësaj, komuna nuk ka mundur ta dijë që furnizimi do të përfundojë në rregull dhe serrat do të montoheshin sipas specifikave teknike.

Për të njëjtin furnizim, komuna ka lidhur edhe një aneks kontratë me të njëjtin OE. Aneks kontrata ka të bëjë me furnizimin shtesë, gjë të cilën AK e kishte arsyetuar me nevojat e mëdha të fermerëve²⁸. Kjo aneks kontratë ishte nënshkruar më 16 dhjetor 2020, në vlerë prej 2,394.50 euro, mirëpo pagesat janë kryer rreth dy muaj më herët, gjegjësisht më 23 dhe 28 tetor 2020, gjë që nuk është e lejueshme dhe si e tillë përmbën shkelje ligjore²⁹.

8. Ndërtimi i infrastrukturës në Lagjen e Re në fshatin Frashër

Tenderi për ndërtimin e infrastrukturës në Lagjen e Re në Frashër ishte publikuar më 12 maj 2020, me vlerë të parashikuar prej 450,000.00 euro. Ky projekt ishte paraparë si bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe buxhetit të fituar nga komuna përmes Grantit të Performancës Komunale (GPF) nga niveli qendror. Kontratën e kishte fituar kompania Urban O.P., me çmim prej 486,186.68 euro, i cili është më i lartë për rreth 36,000 euro sesa vlera e parashikuar. Pavarësisht që legjislacioni i prokurimit e lejon autoritetin kontraktues ta nënshkruajë kontratën³⁰ edhe në rastet kur tejkalohej buxheti, nga ana tjetër, kjo tregon për mosplanifikim të duhur e sidomos kur tre nga katër ofertat kanë tejkeluar buxhetin.

Tabela 8 – Çmimi i ofertave të operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik	Çmimi në EURO
Urban O.P.	486,186.68
N.P.Sh. Bageri	346,722.18
N.N.P. Hysnia	488,158.82
Termomontimi shpk & N.T.Sh. Dina	594,578.17

Kompania N.P.Sh. Bageri ka ofertuar me çmimin më të ulët, kompani e cila është eliminuar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut për shkak të ofertës me çmime jonormalisht të ulëta. Ky eliminim ka ardhur në bazë të llogaritjeve të formulës për çmim jonormalisht të ulët. Mirëpo, komuna ka bërë shkelje të LPP-së në momentin që nuk ka kërkuar sqarime për çmimet e dhëna. Rregullat për tenderë jonormalisht të ulët specifikojnë se operatori ekonomik nuk mund të eliminohej pa i kërkuar këto sqarime. Pra, vetëm atëherë kur autoriteti kontraktues nuk bindet nga sqarimet e ofruara të kompanisë, i njëjti mund të eliminohej.

28 Njoftimi drejtuar KRPP-së për përdorimin e procedurës së negociuar pa publik të njoftimit për kontratë, 25.09.2020.

29 Neni 35, paragrafi 2.2 i LPP-së.

30 Në rast të tejkalimit të vlerës së parashikuar, AK duhet të ndërmarrë masa për t'i siguruar mjetet shtesë.

Nga ana tjetër, dokumentet e dorëzuara nga kompania fituese Urban O.P., kanë disa mangësi. Në Dosje të Tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të jetë i certifikuar për ISO 9606 që ka të bëjë me saldimin, por kompania Urban O.P. nuk ka dorëzuar një certifikatë të tillë. Pra, ky është një rast kur komuna është dashur që ta refuzojë si ofertë për shkak të mospërbushjes së një prej kushteve përcaktuar në DT.

Një tjetër kërkesë e paplotësuar është ajo për inxhinier të diplomuar të elektroteknikës – drejtimi konstruktiv. Kompania Urban O.P. ka dorëzuar dokumentet për një inxhinier i cili ka të përfunduar drejtimin elektroenergjetikë industrial. Për shkak të kësaj, oferta është dashur të refuzohet pasi operatori ekonomik ka prezantuar inxhinier i cili ka drejtim tjetër nga ai që është kërkuar. Sipas LPP-së³¹, ofertat duhet të vlerësohen në bazë të kërkesave të Dosjes së Tenderit.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me kërkesën për inxhinier të diplomuar të arkitekturës – drejtimi hidroteknik. Operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentet për një inxhinier i cili ka drejtim tjetër, atë të arkitekturës. Element tjetër është që kompania Urban O.P. nuk ka dorëzuar referenca për punë të mëparshme për këtë inxhinier. Kërkesa ka qenë që inxhinieri të ketë tetë vite përvojë pune. Po ashtu, është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar 25 punëtorë dhe kjo të dëshmohet përmes listës nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Kompania Urban O.P. ka dorëzuar një listë të tillë, e cila ka vetëm 23 punëtorë. Gjithashtu, ka dorëzuar edhe një listë tjetër në të cilën janë të listuar 30 punëtorë, por e cila është krijuar nga vetë kompania. Pasi kërkesa ka qenë që numri prej 25 punëtorësh të dëshmohet përmes listës nga ATK, atëherë kompania Urban O.P. nuk e ka plotësuar as këtë kërkesë.

Kërkesa nuk është plotësuar as për dy salduesë të certifikuar me ISO 9606 dhe EN 13067. Kompania Urban O.P. ka prezantuar dy salduesë, por asnjëri nuk i posedon të dy certifikatat. I pari është i certifikuar vetëm për EN 13067, ndërsa i dyti për ISO 9606. Të gjitha këto mangësi në ofertën e kompanisë Urban O.P. tregojnë se komisioni i vlerësimit nuk ka bërë vlerësim të mirëfilltë. Në këtë drejtim, Komuna e Mitrovicës së Jugut me dhënien e kontratës ka bërë një sërë shkeljesh ligjore.

9. Dezinfektimi emergjent i hapësirës së disa objekteve shkollore

Komuna e Mitrovicës së Jugut në fund të nëntorit të vitit 2020 kishte shpallur tender përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, kjo si pasojë e COVID-19. Hapja e tenderit është bërë për dezinfektim emergjent të hapësirës së disa objekteve shkollore, pasi disa mësimmshënës kishin rezultuar të infektuar me virus. Në kohën që është hapur tenderi, pandemia kishte kohë që ishte e pranishme, andaj arsytimi i infektimit të mësimmshënësve nuk është arsytim i fortë, duke qenë se kanë pasur kohë mjaftueshëm ta planifikojë iniciimin e procedurës përmes procedurës së hapur. Vlera e parashikuar për këtë tender ka qenë 3,300.00 euro, për të cilin kanë ofertuar vetëm dy operatorë ekonomikë, DDD Preventiva dhe N.Sh. Preventiva (Shaqir Brahimi B.I.). Ky i fundit, N.Sh. Preventiva është shpallur OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë, prej 3.242,50 euro.

31 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, neni 59.

Tabela 9 – Procesverbali i hapjes

Nr.	Tenderuesi	Kodi i tenderit	Pjesë	e-tenderi	Çmimi	Çmimi (me TVSH)	Ndryshimi
1	O Speci e Shërbimit të DD “Preventiva”	Ddd	Dezinfektimi EMERGJENT i hapësirave të disa objekteve shkollore për shkak të infektimit të personelit dhe nxënësve me Covid 19	PO	3,122.41	3,372.20	JO
2	Shaqir Brahimi B.I	Since_2010	Dezinfektimi EMERGJENT i hapësirave të disa objekteve shkollore për shkak të infektimit të personelit dhe nxënësve me Covid 19	PO	2,747.88	3,242.50	JO

Megjithatë, duke qenë që procedura ka qenë e negociuar, komuna është dashur që të ftojë të dy kompanitë në negociatë, për të tentuar kështu që të ulët çmimi³², gjë që nuk është bërë. Në bazë të kalkulimeve sipas Dosjes së Tenderit, vërehet se Komuna e Mitrovicës së Jugut ka paguar 0.25 euro për dezinfektim të një metri katror që është dukshëm më i lirë se në fillim të pandemisë kur është paguar 0.33 euro për këtë shërbim.

Në Dosjen e Tenderit, e vetmja kërkesë të kapaciteti teknik dhe profesional, është ofrimi i dëshmisë së një kontrate për shërbime të njëjta në tri vitet e fundit, duke mos cekur fare vlerën e kontratës. Përveç kësaj, si dëshmi është kërkuar vetëm një listë e kontratave të realizuara, mirëpo LPP e parasheh që përveç listës së kontratave të kërkohej edhe referencat përkatëse³³.

Te një nga dokumentet e kërkuara të kërkesat e përshtatshmërisë, është edhe vërtetimi i gjykatës, që dëshmon që i njëjti OE nuk është shpallur i falimentuar dy vitet e fundit, si dhe nuk është iniciuar procedura e falimentimi apo likuidimit. Vërtetimi në fjalë nuk mund të jetë i lëshuar më shumë se tre muaj, mirëpo OE N.Sh. Preventiva këtë vërtetim e kishte ofruar të shkurtit të vitit 2020, 10 muaj të vjetër, gjë që nuk lejohet.

32 Neni 35.3. 3.Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimi, sasi, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë.

33 Neni 69 i LPP-së – Aftësitë teknike dhe/ose profesionale.

10. Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të komunës dhe institucioneve tjera komunale

Në mars të vitit 2020, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka hapur një tender për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve komunale, në vlerë të parashikuar prej 150 mijë euro. Për këtë aktivitet të prokurimit, kanë ofertuar vetëm dy OE, Valoni-I dhe Univerzal – Comerc, ky i fundit fitues dhe nënshkruer i kontratës kornizë, e cila do të ketë kohëzgjatje prej 36 muajsh. Për këto shërbime, OE Univerzal – Comerc kishte ofertuar me çmim të poentuar prej 7,848.45 euro dhe 37,413.00 euro çmim të papoentuar. Sikundër, OE tjetër Valoni-I ka ofertuar me çmim të poentuar prej 104,877.00 euro, me ç'rast vërehet dallim shumë i madh në çmimet e poentuar të të dy kompanive.

Një nga kategoritë e tenderëve, ku më së shumti ka dallime ndërmjet çmimeve të kontratës dhe atyre të tregut janë pikërisht ato të mirëmbajtjes së automjeteve. Për shkak të pamundësisë për ta paracaktuar sasinë e pjesëve të veturës që kanë nevojë të mirëmbahen, si procedurë përdoret ajo e poentimit të çmimit për të lidhur kontratën. Pra, procedura e poentimit të çmimit është një procedurë e cila përdoret në prokurimin publik për rastet kur autoriteti kontraktues “nuk e di” sasinë e artikujve që do të porosisë, dhe për këtë qëllim secili artikull në listë të çmimeve e ka sasinë “1”. Zakonisht, gjatë zbatimit të kontratës, porositë bëhen varësisht prej nevojave që dalin. Lista e çmimeve ndahet në disa kategori dhe secilës prej tyre u jepet një peshë e caktuar në totalin prej 100%. Poentimi i çmimeve shërben vetëm për t'i vlerësuar ofertat, ndërsa kontrata zbatohet me çmimet për njësi.

Si në tenderët e përmendur më lart, edhe në këtë tender ka disa probleme në lidhje me kërkesat e përcaktuara dhe kriterit për dhënie të kontratës. Në Dosje të Tenderit është kërkuar që OE të dëshmojë përvojën në këtë fushë, me një kontratë dhe tri referenca. Zakonisht, kontratat dhe referenca bëhen bashkë për arsye se kontrata nuk dëshmon që puna ka përfunduar. Në këtë rast, kërkesa për një kontratë dhe tri referenca nuk është e arsyeshme sepse, kërkesa është dashur të jetë dorëzimi i listës së kontratave të përfunduar në tri vitet e kaluara dhe t'i bashkangjiten si dëshmi referenca ose raporte të pranimit.

Kriteri për dhënie të kontratës ka qenë çmimi më i ulët i poentuar, mirëpo komuna ka përdorur edhe pjesë të çmimit ekonomikisht më të favorshëm. Përderisa lista e çmimeve është plotësuar sipas përqindjeve të ndara për secilin kategori, komuna ka shtuar edhe dy kritere tjera, garancionin, të cilit i ka dhënë peshë pesë pikë dhe largësisë së garazhës nga objekti i komunës i ka dhënë peshë 15 pikë. Komuna e ka ndarë kriterin në pesë kategori, ku për tri kategori është vendosur vlera monetare, ndërsa për dy të tjerat u janë vendosur pikët. Në këtë rast, komuna ka përzier kriteret dhe ka krahasuar çmimet e dy operatorëve pjesëmarrësë. Kjo gjë është e ndaluar në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, përkatësisht në nenin 28.15 të RrUOPP, ku thuhet se “**Rreptësishtë ndalohet krahasimi i çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra-tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritura në pikë, mandej të peshohen pikët pasi që në këtë mënyrë pikët më të larta të poentuar jo domosdoshmërisht do të rezultojnë në çmimin më të ulët**”³⁴.

Pra, kriteri me çmimin më të ulët të poentuar mund të përdoret vetëm kur ka kategori në të cilën shënohet çmimi, e jo të shtohet garancioni dhe largësia e garazhës, për të cilat nuk mund të vendoset çmim. Siç është paraqitur më poshtë, shkelja më e madhe është bërë në rastin e krahasimit të çmimeve të dy operatorëve ekonomikë në tri kategoritë e para.

³⁴ Rregullat dhe udhëzuesi operativ i prokurimit publik, neni 28.5: <https://bit.ly/3F7ZW9W>

Tabela 10 - Përshkrimi i kriterëve, pesha dhe metoda e vlerësimit të njërit prej operatorëve ekonomikë

Nr.	Përshkrimi i kriterëve	Pesha	Metoda e Vlerësimit
1	Një orë punë efektive për servisim (pozicioni nr 1)	Ora efektive e punës e cila llogaritet në bazë punës efektive për ndërrimin të pjesëve	15 pikë $36:90 \times 15 = 6$ pikë
2	Çmimi për servisim prej pozicionit nr nga (2-21)	Pjesët për servisim të cilat janë më të shpeshta për ndërrim dhe servisim të rregullt (furnizimi dhe montimi)	55 pikë $10,373:23,400 \times 55 = 24$ pikë
3	Çmimi për pjesët tjera rezervë furnizimi dhe montimi nga nr. (22-129)	Pjesët tjera rezervë të cilat janë më të rralla për ndërrim (furnizim dhe montim)	10 pikë $27,040:81,450 = 3.31$ pikë
4	Garancioni për pjesët e montuara – deklaratë me shkrim.	Garancioni për pjesët e montuara në vite-min 1 vit. Deklaratë me shkrim	5 pikë 0 pikë nuk ka garancion
5	Distanca apo largësia deri objekti për servisim në kilometrat min 5 km max. 15	Llogaritet distanca nga qyteti për shkak të shpenzimeve deri objekti i servisit (si për shpenzimet e bartjes ashtu edhe për intervenime të shpejta).	15 pikë Më pak se 5 km = 15 pikë

Për kategorinë e parë, për një orë pune Univerzal Comerc ka dhënë çmim 36 euro, me ç'rast është poentuar nga komuna me maksimumin e pikëve, 15 pikë. Mirëpo, për ofertën DPT Valoni-I, çmimi është peshuar në bazë të çmimit të Univerzal Comerc dhe ka marrë vetëm gjashtë pikë.

Përzjerja e dy kriterëve të ndryshme ka mundur të dërgojë në një situatë të tillë, si p.sh. kompania A të ketë më shumë pikë se kompania B, mirëpo kompania B të ketë çmim më të ulët të poentuar. Kjo do të mund të ndodhte nëse ofertat do të ishin të përafërta me çmim, mirëpo kompania më e lirë do të merrte shumë pak pikë për garancionin dhe largësinë e objektit të garazhës.

11. Furnizim me material higjieniko-sanitar për komunë, shkolla dhe institucione tjera komunale

Komuna e Mitrovicës së Jugut, në nëntor të vitit 2020, ka iniciuar një tender për furnizim me material higjienik për komunën, shkollat dhe institucionet tjera komunale. Komuna për këtë tender kishte rezervuar buxhet prej 120,000.00 euro për tri vite sa do të zgjasë kontrata. Në këtë tender kanë ofertuar shtatë kompani, nga të cilat me kontratë është shpërblyer N.T.Sh. Genci, me 78.25 euro për njësi.

Te kërkesat mbi mundësitë profesionale, është kërkuar nga operatorët ekonomikë të ofrojnë dëshmi që në tri vitet e fundit kanë zbatuar kontrata në vlerë prej një minimumi 180,000.00 euro. Për ta dëshmuar plotësimin e kësaj kërkesë, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka kërkuar që të dorëzohet një listë e nënshkruar nga kompania dhe e njëjta të jetë në origjinal. Po ashtu, është kërkuar që në listë të specifikohen informatat lidhur me shumën, kohën, vendin, dhe numrin e prokurimit. Në këtë drejtim, fituesi i këtij tenderi, N.T.Sh. Genci nuk ka dorëzuar listën e kontratave, por ka dorëzuar vetëm kontrata, të cilat e plotësojnë shumën e kërkuar, por jo edhe kërkesën e komunës që të ofrojë listë.

Çmimet me të cilat ka ofertuar OE Genci në disa artikuj që janë listuar në tabelën më poshtë, kanë qenë çmime jonormalisht të ulëta. Siç e kemi cekur edhe për tenderë tjerë, autoriteti kontraktues në bazë të LPP-së³⁵ duhet të kërkojë sqarime se pse operatori ekonomik ka ofertuar me ato çmime. Në rast se edhe pas marrjes së informacioneve, AK vendosë që tenderi është jonormalisht i ulët dhe me të njëjtat çmime nuk mund të implementohet kontrata, oferta mund të refuzohet.

Tabela 11 - Disa artikuj me çmime jonormalisht të ulëta nga oferta financiare e OE GENCI

Nr.	Artikulli	Çmimi	Nr.	Artikulli	Çmimi
1.	Sprej arome – dezodorant	0.05 euro	15.	Reflektor (ndriçim i lartë) 500 wat (led)	0.05 euro
2.	Shpuze për xhokera	0.05 euro	16.	Lopatë të borës me bisht (metalike)	0.05 euro
3.	Mantela pune	0.05 euro	17.	Kapse te mbeturinave me bisht	0.05 euro
4.	Çizme gome	0.05 euro	18.	Gumë vakum	0.05 euro
5.	Brushë e fortë për dysheme 50 cm	0.05 euro	19.	Gumë për kolicë	0.05 euro
6.	Asepoll për dezinfektim 1 liter	0.10 euro	20.	Fshisë PVC	0.10 euro
7.	Kantë me rrote për mbeturina 120 l	0.15 euro	21.	Pjatë PVC (1/50)	0.05 euro
8.	Tela të enëve	0.05 euro	22.	Piruna PVC (1/100)	0.50 euro
9.	Aparat për air wick (ose ekuivalent)	0.05 euro	23.	Lugë PVC (1/100)	0.05 euro
10.	Bateria 1.5wat të mëdha 1/2 AA	0.01 euro	24.	Lopatë PVC	0.50 euro
11.	Bateria 1.5wat të mëdha 1/2 AAA	0.01 euro	25.	Seloteip i madh	0.05 euro

35 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, neni 61.

12.	Brave dere (dimensione standarde)	0.05 euro	26.	Seloteip i madh	0.05 euro
13.	Bagllame dere (15 cm 1/4)	0.25 euro	27.	Çizme gome (nr.42-46)	0.05 euro
14.	Drita me sensor	0.05 euro			

Sipas kësaj table, OE fitues do ta furnizojë AK-në me shumicën e këtyre artikujve me vetëm 0.05 euro, çmim i cili rrezikon implementimin e kontratës.

12. Furnizim i shkollave me lëndë djegëse -dru- për ngrohje dhe institucione tjera komunale.

Një tjetër tender që Komuna e Mitrovicës së Jugut e kishte hapur në gusht të vitit 2020 është furnizim i shkollave me lëndë djegëse "dru" për ngrohje dhe institucione tjera komunale. Për këtë aktivitet të prokurimit ka tenderuar vetëm një GOE, Vëllezërit Kaçandolli & N.T.P. Haxha. Vlera e parashikuar për të këtë tender ishte 230 mijë euro, derisa kontrata është nënshkruar³⁶ me vetëm 50 euro më pak, me 229,950.00 euro. Çmimi që ky konsorcium kishte vendosur për një metër kub dru është 43.80 euro, ku përfshihet copëtimi, çarja dhe transporti i drunjtëve, derisa palimi i tyre dhe vendosja në depo duhet të bëhet nga njësia kërkuese. Vlera indikative që mund të porositet për tri vite, meqë është kontratë kornizë është 5250 m³.

Tabela 12 – Paramasa e kontratës për furnizim me lëndë djegëse dru për ngrohje

Nr.	Lloji i artikullit:	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	TVSH	Çmimi njësi me TVSH	TOTALI: Gjithsejt
1	Furnizimi me lëndën djegëse DRU për shkolla dhe Institucione tjera. Vërejtje: Në çmimin furnizimit përfshihet: Transporti, prerja dhe copëtimi nga përfituesi ose nënshkruesi i kontratës ndërsa vendosja në DEPO dhe palimi duhet të kryhet nga njësia kërkesue	m ³	5,250	37.12	6.68	43.80	229,950.00
GJITHSEJ TOTALI ME TVSH:				37.12	6.68	43.80	229,950.00

Për dorëzim të ofertave, AK kishte shkurtuar afatin nga 40 ditë në 15 ditë, të cilën e kishte arsyetuar me faktin se MASHTI nuk ka njoftuar nëse mësimi do të jetë i rregullt apo nga distanca dhe vendimi ishte marrë në moment të

³⁶ Kontrata është nënshkruar më 05.10.2020.

fundit. Gjithsesi, për shkurtrimin e afatit me legjislacionin e prokurimit, janë paraparë disa rregulla. Sipas RrUOPP-së, shkurtimi apo reduktimi i afatit mund të bëhet vetëm nëse njoftimi paraprak në fjalë i ka të gjitha informatat e nevojshme të specifikuara, si dhe nëse i njëjti njoftim është publikuar jo më pak se 40 ditë dhe jo më shumë se 12 muaj para publikimit të Njoftimit për Kontratë në fjalë³⁷.

Te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, AK kishte kërkuar që të ofrohen dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të njëjta në vlerë prej minimum 345,000.00 € për tri vitet e shkuara, e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontratë, ku lideri duhet t'i plotësojë 60% (207,000.00€) të kërkesës. Pas analizimit të ofertës së fituesit dhe ofertuesit të vetëm në këtë tender, është vërejtur që konsorciumi nuk e ka plotësuar këtë kërkesë.

Një prej referencave të dorëzuara³⁸ nga OE Vëllezërit Kaçandolli, të cilën ia kishte lëshuar po e njëjta komunë, arrin shumën prej 336,095.85 euro, shumë e cila ishte tejkualuar 78% të vlerës indikative të kontratës bazë me vlerë totale prej 188,160.00 euro. Sipas referencës, shuma prej 336,095.85 euro është arritur duke e shfrytëzuar +-30%, mirëpo duke e llogaritur shumën e kontraktuar 188,160.00 euro dhe shumën shtesë që është paguar prej 147,934.85 euro, tejkalon jo +30%, por 78%. Sipas LPP-së, nëse urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë, duke përfshirë +30%, pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të kontratës publike kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht³⁹. Sipas kësaj dispozite, Komuna e Mitrovicës së Jugut, edhe këtë kontratë të cilën OE fitues e kishte dorëzuar si referencë, ia kishte vazhduar jashtëligjshëm.

Referencën tjetër⁴⁰ që anëtari tjetër i konsorciumit, OE N.T.P. Haxha e kishte dorëzuar si dëshmi, sipas LPP-së nuk mund të pranohet⁴¹. Kjo kontratë e lidhur me Komunën e Skenderajt në vlerë totale prej 327,362.00 euro si datë të përfundimit ka datën 31.07.2021, kontratë e cila nuk ka qenë e përfunduar në momentin e dorëzimit të ofertës. Andaj, sipas dëshmive të ofruara, konsorciumi Vëllezërit Kaçandolli & Haxha, nuk e kanë plotësuar kërkesën për dorëzimin e punëve të realizuara në shumën prej 345,000.00 euro, ofertë e cila është dashur të shpallet si e papërgjegjshme.

37 Neni 6.5 i RrUOPP-së.

38 Referencë e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit, Komuna e Mitrovicës së Jugut për OE Vëllezërit Kaçandolli, datë: 09.09.2020.

39 Neni 38.2. i LPP-së.

40 Referencë e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit, Komuna e Skenderajt për OE N.T.P. Haxha, datë: 02.09.2020.

41 Neni 69 i LPP-së.



Komuna e Gjilanit

13. Mbushja me dezinfektantë dhe mirëmbajtja e tyre

Komuna e Gjilanit, më 9 qershor 2020 hapi tender për mbushje të dezinfektantëve dhe mirëmbajtjen e tyre. Procedura me të cilën është zhvilluar ky tender është ajo me negociim, për të cilin ishin parashikuar 2,400.00 euro. E ftuar në këtë aktivitet të prokurimit ka qenë vetëm kompania “Every Day VM”, e cila është shpërblyer me kontratë me të njëjtën vlerë, prej 2,400.00 euro.

Inicimi i procedurës me negociim nuk nënkupton të drejtën e autoritetit kontraktues që të ftojë vetëm një operator ekonomik. Meqenëse, me tregtinë dhe shpërndarjen e dezinfektuesve nuk merret vetëm kjo kompani, komuna është dashur të ftojë më shumë kompani, për shkak të mundësuar konkurrencë të drejtë së drejtë dhe ofruar mundësinë për më shumë kompani të ofertojnë në tenderët publikë.

Pavarësisht kësaj, çmimet me të cilat ka ofertuar kompania “Every Day VM”, janë shumë më të ulëta se ato të tregut, e që legjislacioni i prokurimit i njeh si çmime jonormalisht të ulëta. Në bazë të analizës së tenderit, vërehet që në aneksin 1 të specifikimit teknike të detyrueshme, është cekur që mbushja me dezinfektuesë duhet të bëhet për tunelin dezinfektues, ku për një litër dezinfektues, ky operator ka ofertuar me 0.25 euro, çmim ky shumë i ulët në krahasim me çmimin e tregut. Në një nga hulumtimet e D+ lidhur me kontratat emergjente në kohë të pandemisë⁴², janë krahasuar edhe çmimet e dezinfektuesve një (1) litërsh. Sipas këtij krahasimi, në kontratat e lidhura me negociim, çmimi për një dezinfektues për periudhën kohore korrik-dhjetor 2020, është 7.74 euro, ndërsa në kontratat, ku procedura ka qenë e hapur, një dezinfektues i tillë është blerë për 2.94 euro. Ky krahasim vë në pah çmimet e larta të lidhura përmes negociimit, mirëpo çmimi i dhënë prej 0.25 euro nga “Every Day VM” është shumë i ulët dhe si rast është përjashtues.

Një element tjetër në këtë tender është vonesa në publikimin e njoftimit për nënshkrim të kontratës në e-Prokurim. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik⁴³, autoriteti kontraktues brenda dy ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet ta përgatisë këtë njoftim. Mirëpo, Komuna e Gjilanit e ka bërë publikimin e këtij njoftimi pas 10 ditësh, përkatësisht më 16 korrik 2020, derisa kontratën e kishte nënshkruar më 6 korrik 2020.

⁴² Demokraci Plus, Kontratat emergjente dhe ulja e konkurrencës në prokurim publik, qershor 2021: <https://bit.ly/3yUm1X0>

⁴³ Ligji nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, neni 41/A.

Përveç kësaj, në ofertën e kompanisë “Every Day VM”, deklarata nën betim nuk është dorëzuar siç duhet. Si dokument, ligji e parasheh që të nënshkruhet nga persona të autorizuar të operatorit ekonomik, por në rastin konkret nuk është bërë një gjë e tillë. Deklarata nën betim është nënshkruar nga një person tjetër, i cili në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) nuk figuron as si pronar dhe as si person i autorizuar i kompanisë në fjalë. Në këtë rast, për t’u pranuar si dokument, është dashur të bashkëngjitet edhe autorizimi nga drejtori i OE-së. KRPP konsideron se nënshkrimi “për” në emër të përfaqësuesit të operatorit ekonomik, nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm⁴⁴.

Pastaj, disa parregullsi janë vërejtur edhe në faturat e siguruara, të cilat janë kryer pasi ka përfunduar kontrata. Pra, kontrata është nënshkruar në korrik të vitit 2020, me kohëzgjatje prej tre muajsh, ndërkaq një pagesë në vlerë prej 556 euro është bërë në prill të vitit 2021, rreth gjashtë muaj pas skadimit të kontratës dhe jashtë vlerës së parashikuar. Pavarësisht që kontrata është kornizë dhe tejkalimi i vlerës lejohet deri në 30%, ajo nuk është bërë brenda kohës së vlefshmërisë së kontratës.

14. Furnizim me maska dhe material dezinfektues

Përmes procedurës së negociimit, Komuna e Gjilanit ka iniciuar edhe një tender tjetër për t’u furnizuar me maska dhe material dezinfektues. Ky tender është hapur rreth një muaj pas infektiveve të para me COVID-19, saktësisht më 17 prill 2020. Vlera e parashikuar për këtë kontratë ka qenë 9,900.00 euro dhe me të njëjtin çmim është lidhur edhe kontrata me të ftuarin e vetëm nga kjo komunë, kompaninë “Liridona Q Selmani”. Sikurse në tenderin paraprak, edhe në këtë tender, për të ofertuar është ftuar vetëm një operator ekonomik. Ftesa e vetëm një operatori ekonomik, sidomos një operator i cili nuk e ka as veprimtari furnizimin me maska e as me material dezinfektues, është veprim që dëmton konkurrencën. Gjithashtu, një ftesë e tillë nga Komuna e Gjilanit, e vetëm një operatori që furnizimin me maska dhe material dezinfektues nuk e ka as punë primare dhe as sekondare, mund të sjellë cilësi të dobët dhe të pakontrolluar të produkteve.

Në paramasën e përgatitur nga Komuna e Gjilanit janë listuar vetëm dy produkte, maska për një përdorim dhe dezinfektuesë, mirëpo nuk është specifikuar sasia që një dezinfektues duhet të përmbajë. Mospërcaktimi i sasisë lë hapësirë edhe për keqmenaxhim të kontratës, pasi as menaxheri i kontratës nuk mund ta dijë se çfarë dezinfektuesish duhet të pranojë nga operatori ekonomik.

Furnizimi total është bërë brenda një dite, ditën edhe kur është nënshkruar kontrata. Ndërkaq, vlen të theksohet se as në faturë dhe as në raportin e menaxherit të projektit nuk figuron se a është dorëzuar dezinfektuesi 100 ml, 250 ml, 500 ml, 1 litërsh apo e ndonjë sasi tjetër.

Tabela 13 - Çmimi me të cilin ka ofertuar “OE Liridona Q Selmani”

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në euro
1	Maskë medicinale një përdorimshë	Cope	10000	0.79	7,900.00
2	Dezinfektues	Cope	1000	2	2,000.00
Gjithsej					9,900.00

⁴⁴ Pyetjet e shpeshta të KRPP-së (Pyetja 40) - Si të vepohet në rastet kur dosja e tenderit, përfshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të operatorit ekonomik ofertues, nga një person i paautorizuar?

15. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative për Drejtorinë e Arsimit

Një tender tjetër i Komunës së Gjilanit, është ai për furnizim me pajisje të teknologjisë informative për Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Gjilanit. Ky aktivitet i prokurimit në fazën e parë është zhvilluar nga AQP. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik⁴⁵, ky institucion ka tri përgjegjësi: 1) të zhvillojë prokurime të përbashkëta për autoritetet kontraktuese, b) me kërkesën e autoriteteve kontraktuese të kryejë aktivitete të prokurimit në emër të tyre dhe c) me kërkesën e autoriteteve kontraktuese të ndihmojë në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit. Në rastin konkret, AQP ka zhvilluar aktivitet të përbashkët të prokurimit, ku ka përzgjedhur operatorët që i kanë plotësuar kushtet, të cilët pastaj duhet të ftohen nga autoritetet përkatëse kontraktuese që të ofertojnë për mini-tenderët apo siç njihen kontrata ndihmëse⁴⁶. Sipas këtij rregulli, autoriteti kontraktues duhet t'i ftojë vetëm operatorët që janë palë në kontratën kornizë të nënshkruar nga AQP. Në mini-tenderin e iniciuar nga Komuna e Gjilanit, vlera e parashikuar për këtë tender ka qenë 107,000.00 euro. Nga gjashtë operatorë ekonomik që kanë ofertuar në këtë tender, fitues është përzgjedhur konsorciumi Iliri-Kosova Sh.P.K. & Comtrade Computers O.K., me çmimin më të lirë prej 127,740.00 euro. Mirëpo, çmimi i kontratës fituese kishte kaluar 20,000.00 euro mbi vlerën e parashikuar, gjë që sipas KRPP-së, në rastet kur autoriteti kontraktues e tejkalon vlerën e parashikuar, duhet ta arsyetojë bindshëm një gjë të tillë.

Tabela 14 - Çmimet e ofertuara nga "Ilir - Kosova Sh.P.K. & Comtrade Computers O.K."

Nr.	Përshkrimi	Specifikacioni teknik minimal	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Shtëpizë kompjuteri	Brand Name PC - Model I - Shtëpizë kompjuteri sipas të dhënave të shënuara në Aneksin nr.1 - Specifikat teknike të Detyrueshme	127	420.00	53,340.00
2	Monitor kompjuteri	Brand Name Monitor - Model I - Monitor kompjuteri sipas të dhënave të shënuara në Aneksin nr.1 - Specifikat teknike të Detyrueshme	54	100.00	5,400.00
3	Laptop Llaptop - Modeli 1 - sipas të dhënave të shënuara në Aneksin nr. 1 - Specifikat teknike të detyrueshme.			750.00	69,000.00
92					
Gjithsej					127,740.00

Gjatë analizimit të këtij tenderi, janë evidentuar disa parregullsi në ofertën e konsorciumit fitues. Deklarata nën betim është kusht administrativ për të dëshmuar përshtatshmërinë e operatorit ekonomik për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit⁴⁷. Në këtë aktivitet, konsorciumi "Ilir - Kosova Sh.P.K. & Comtrade Computers O.K." ka ofruar dy deklarata nën betim për të dy anëtarët e konsorciumit.

Deklarata nën betim e anëtarit të parë, "Ilir - Kosova", ka emrin e një përfaqësuesi dhe vulën e kompanisë, mirëpo nënshkrimi që është vendosur dallon nga nënshkrimi që i njëjti përfaqësues ka vendosur në kontratë, gjë që nxitë dyshime që i njëjti person nuk e ka nënshkruar të njëjtën deklaratë.

⁴⁵ Ligji nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, neni 95.

⁴⁶ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, neni 56, pika 39.

⁴⁷ Ligji nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, neni 65.

Tabela 15 - Nënshkrimi i drejtorit të : “ILIR – KOSOVA” në deklaratën nën betim

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE	Ilir Kosova sh.p.k
Adresa e plotë:	Fuad Pashe Dibra 23
I përfaqësuar nga:	
Emri	Albert Fazlija
Pozita	GM
Nënshkrimi	
Data	15.02.2021
Vula	

Tabela 16 - Nënshkrimi i drejtorit të ILIR – KOSOVA në kontratë

Emri	Albert Fazlija
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	Nënshkrimi
Data:	17.03.2021
Vula:	Vula

Pastaj, si mangësi tjetër e ofertës së konsorciumit, është mungesa e deklaratës së nënshkruar nga dy anëtarët e tij, deklaratë në të cilën konfirmohet pjesëmarrja e tyre në grup dhe se të njëjtit nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër ofertues në të njëjtën procedurë të prokurimit⁴⁸.

Deri në momentin e lejimit të qasjes në lëndën e pagesave, furnizimi është kryer deri në vlerë prej 48,140.00 euro. Nga 37 faturat e dorëzuara, nuk është blerë asnjë laptop nga 92 sosh sa janë paraparë të porositen sipas kontratës.

16. Mirëmbajtja verore e rrugëve në Komunën e Gjilanit

Komuna e Gjilanit, në shkurt të vitit 2021, kishte hapur tender për mirëmbajtje verore të rrugëve. Për këtë tender kanë ofertuar pesë operatorë ekonomikë, ku fitues është shpallur “EL-BAU Sh.P.K.”. Procedura e prokurimit ka qenë e hapur dhe kanë ofertuar pesë operatorë ekonomikë.

⁴⁸ Ligji nr. 04/L-042 për Prokurim Publik, neni 71.2.

Tabela 17 - Procesverbali i hapjes

Nr.	Tenderuesi	Kodi i tenderit	Pjesë	E-tenderit	Çmimi	Çmimi (me TVSH)	Ndryshimi/ Plotësimi
1	COMPANY“BEJTA COMMERCE”SH.A.,, Gurthyesi “GLLAMË” P.N, 60000, GJILAN	4/2021	Mirëmbajtja verore e rugëve në Komunën e Gjilanit	PO	107.25	126.55	JO
2	“TALI” SH.P.K, E Bujanovcit, 60000, Gjilan	02/2021	Mirëmbajtja verore e rugëve në Komunën e Gjilanit	PO	89.60	105.73	JO
3	EL-BAU SH.P.K., LIMOS STANECI P.N., GJILAN	05.03.2021	Mirëmbajtja verore e rugëve në Komunën e Gjilanit	PO	126.36	149.10	JO
4	Grupi i organizatorëve ekonomik AVAG GROUP SH.P.K: EING COM SH.P.K: Fazli Grajqevci, Nr.24/1 1000 Prishtinë	Gjilan MIRMBAJTJA VERORE	Mirëmbajtja verore e rugëve në Komunën e Gjilanit	PO	10.76	12.70	JO
5	Grupi i operatorëve	01/2021	Mirëmbajtja	PO	83.88	98.88	JO

Kontrata e nënshkruar me operatorin ekonomik “EL-BAU” është nënshkruar si kontratë kornizë për periudhë trevjeçare. Vlera totale e kësaj kontrate është 1,560,000.00 euro, ku për çdo vit është llogaritur për t’u shpenzuar 520 mijë euro. Në njoftimin për kontratë, vlera e parashikuar e kontratës është 520 mijë euro, pra e njëjta gjë nuk ka reflektuar në kontratën e nënshkruar me operatorin ekonomik “EL-BAU”.

Sa i përket njëres prej kërkesave të vëna në Dosje të Tenderit, është cekur që udhëheqësi i punimeve duhet ta ketë një vit përvojë pune, të cilën operatori “EL-BAU” e kishte plotësuar. Mirëpo, është e rëndësishme të theksohet që për inxhinierë të tjerë, kërkesa për vite përvojë pune ka qenë shumë më e madhe, deri në pesë vite. Pra, pavarësisht që si kërkesë është plotësuar nga operatori fitues, i njëjti nuk do ta plotësonte sikur komuna do të kërkonte më shumë vite përvojë pune, siç edhe i ka kërkuar për inxhinierët tjerë.

Te kërkesat teknike dhe profesionale, janë listuar edhe pajisjet që duhet të dorëzohen në ofertë. Në mesin e pajisjeve që kishte dorëzuar operatori “EL-BAU”, njëra prej tyre nuk i kishte plotësuar kërkesat e komunës, përkatësisht për kamionin kiper me kran – dy dyer, përveç që e kishte tejkalluar peshën e lejuar të automjetit prej 2-3 tonë (sepse ishte 5,422 tonë), i njëjti mjet ishte dorëzuar në ofertë edhe i paregjistruar. Pra, si ditë e fundit e validitetit në certifikatën e regjistrimit të automjetit është data 2 maj 2020, rreth shtatë muaj para hapjes së tenderit, automjet i cili nuk mund të prezantohet në ofertë.

17. Furnizim me veshmbathje për punëtorët e Komunës së Gjilanit

Komuna e Gjilanit, në qershor të vitit 2020, ka hapur tender për të blerë veshmbathje për punëtorët e Komunës së Gjilanit me vlerë të parashikuar prej 30,695.00 euro. Ky tender ishte ndarë në dy lloje, lloji 1 për veshmbathje të punëtorëve, ndërsa lloji 2 për t'i furnizuar me uniformë stafin e Drejtorisë së Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës. Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar tre operatorë ekonomik në të dy llojet. Nga vlerësimi i ofertave, fitues ka rezultuar "Meti Commerce Sh.P.K.", në të dy llojet, në vlerë totale prej 24,619 euro.

Tabela 18 - Procesverbali i hapjes

Nr	Tenderusi	Kodi i tenderit	Pjesë	e-tenderi	Çmimi	Çmimi (me TVSH)	Ndryshimi
1	Meti Commerce SH.P.K Agim Rashiti 5, 60000, Gjilan	118148	Furnizim me veshmbathje për punëtorët e Komunës së Gjilanit – LOT 1	PO	18,356.66	21,660.00	JO
2	Meti Commerce SH.P.K Agim Rashiti 5, 60000, Gjilan	118148	Furnizim me uniformë për stafin e drejtorisë së Kadaset, Gjeodezi dhe Pronë.	PO	2,507.66	2,959.00	JO
3	"Sankos" Sh.p.k rr. "Vëllëzërit Çaka" pa, 71000, Kaçanik	Sankos line	Furnizim me veshmbathje për punëtorët e Komunës së Gjilanit – LOT 1	PO	21,830.51	25,760.00	JO
4	"Sankos" Sh.p.k rr. "Vëllëzërit Çaka" pa, 71000, Kaçanik	Sankos line	Furnizim me uniformë për stafin e drejtorisë së Kadaset, Gjeodezi dhe Pronë.	PO	3,699.15	4,365.00	JO
5	"RIMI-ALTEX" SH.P.K., D.E KOMBIIT, 70000, FERIZAJ	29.06.2020	Furnizim me veshmbathje për punëtorët e Komunës së Gjilanit – LOT 1	PO	20,372.57	24,040.00	JO
6	"RIMI-ALTEX" SH.P.K., D.E KOMBIIT, 70000, FERIZAJ	29.06.2020	Furnizim me uniformë për stafin e drejtorisë së Kadaset, Gjeodezi dhe Pronë.	PO	3,855.00	4,549.00	JO

Të vetmen kërkesë të cilën Komuna e Gjilanit e kishte vendosur te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale ka qenë dorëzimi i mostrave të mbyllura në një paketim, dorëzim të cilin kompanitë e kanë bërë në ditën e hapjes së ofertave. Përveç kësaj, komuna si periudhë të vlefshmërisë së tenderit e kishte cekur periudhën kohore prej 120 ditë, mirëpo për tender të vlerës së mesme, vlefshmëria e tenderit mund të kërkohet për 60 ditë plus 30 ditë, pra për gjithsej 90 ditë⁴⁹, e jo siç e ka caktuar komuna në këtë rast.

18. Ndërtimi i Tregut të Gjelbër në Komunën e Gjilanit

Komuna e Gjilanit, në prill të vitit 2021, ka nënshkruar kontratë për ndërtimin e Tregut të Gjelbër në vlerë prej 509,177.24 euro. Tenderi në fjalë është zhvilluar përmes procedurës së negociuar, nga i cili proces është shpallur fitues operatori ekonomik “Ceni Company”. I njëjti OE ka qenë pjesë e konsorciumit që e kishte fituar tenderin edhe herën e parë, për të njëjtën punë. Pra, ky është tenderi i dytë për punë të njëjtë që është shpallur nga Komuna e Gjilanit. Përdorimi i procedurës së negociuar është bërë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik⁵⁰, duke qenë se për nga natyra e punëve dhe vlerës së kontratës, procedura e tenderimit është dashur të jetë publike. Komuna e Gjilanit ka mundur të zgjedhë procedurën e negociuar nëse nuk do të kalonte 10% të vlerës së kontratës së parë, që ishte dhënë për ndërtimin e Tregut të Gjelbër të njëjtës kompani (por në konsorcium me “EL-BAU”), e atë në vlerë prej 871,173.42 euro. Me fjalë tjera, komuna ka mundur të lidhë kontratë me negocim si punë shtesë, me kusht që nuk kalohet shuma prej 87,117.34 euro. Mirëpo, meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me vlerën prej 509,177.24 euro, del që shuma e vlerës ka kaluar mbi 58% të vlerës së kontratës së parë⁵¹. Vlen të theksohet se komuna nuk e ka iniciuar këtë tender as si punë shtesë, andaj edhe trajtimi në analizën që do t'i bëhet këtij tenderi do të jetë vetëm si tender me procedurë të negociuar.

Në Dosjen e Tenderit nuk ishte kërkuar asnjë kërkesë për gjendjen ekonomike dhe financiare dhe as kërkesa teknike dhe profesionale, gjë që për tenderët e kësaj natyre dhe të kësaj peshe, kërkohen gjithmonë. Komuna në këtë rast kishte ftuar tre operatorë ekonomikë, duke mos ua përcaktuar asnjë kusht me të cilin do ta mbështesnin ofertën e tyre. Pavarësisht kësaj, kishte ofertuar vetëm “Ceni Company”, që siç është cekur më lart është njëri prej zbatuesve të kontratës së parë për kryerjen e punëve të njëjta. Po ashtu, nëse procedura do të ishte e hapur, afati për të ofertuar do vlente 40 ditë, mirëpo në këtë rast është përdorur afati prej pesë (5) ditësh.

Komuna, arsyetimin për ta zhvilluar si procedurë të negociuar, ia kishte dërguar KRPP-së, përmes njoftimit për përdorim të procedurës së negociuar. Si arsye ceket tërheqja e disa pozicioneve nga paramasa, duke qenë se lidhen fizikisht dhe teknikisht me pjesët e kryera me kontratën e parë, e sipas kësaj është e pamundur të vihet në funksion. Sipas Komunës së Gjilanit, nuk duhet të ketë vonesa shtesë, pasi rrezikohet projekti fillestar dhe si rezultat dëmtohen fermerët, bujqit, tregtarët dhe qytetarët.

Sipas analizës që i është bërë tenderit dhe paramasës në veçanti, arsyetimi i komunës nuk është i drejtë pasi shumë pozicione dhe kategori janë porositur edhe herën e dytë, madje duke dyfishuar dhe trefishuar sasinë dhe çmimin në disa raste. Punët e përsëritura të cilat gjenden edhe në kontratën e parë dhe në kontratën e dytë kanë të bëjnë me punët e suvatimit, punët e nivelizimit, punët e veshjes së dyshemesë dhe mureve dhe punët e kulmit. Më poshtë janë paraqitur shembuj se si metrat katrorë janë dhjetëfishuar në shumë raste, gjë që tregon për keqplanifikim dhe keqmenaxhim nga ana e Komunës së Gjilanit.

⁴⁹ Neni 31.2 i RrUOPP-së.

⁵⁰ Ligji i Prokurimit Publik, neni 35.

⁵¹ Neni 35 2.4. i Ligjit të Prokurimit Publik

Tabela 19 - Paramasa për “punët e suvatimit” - kontrata e parë

PUNËT E SUVATIMIT					
Poz. 6	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi në Euro	Çmimi total me të gjitha taksat e aplikuara në Euro
6.1	Furnizimi me material dhe suvatim i mureve të brendshme për administratën, me material të gatshëm për suvatim në trashësi 2.0cm të punuar në dy shtresa. Shtresa e parë llaq i vazhduar, Shtresa e dytë glet masë, të përfundohet deri në fazën e ngjyrosjes.	m ²	224.1	8.00	1,792.8 euro
6.2	Furnizimi me material dhe suvatimi i plafoneve me material të gatshëm për suvatim në trashësi 2.0 cm të punuar në dy shtresa për pjesën e administratës. Shtresa e parë llaq i vazhduar, Shtresa e dytë gjet masë, të përfundohet deri në fazën e ngjyrosjes.	m ²	190.8	8.00	1,526.4 euro
6.3	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të toaleteve dhe kuzhinës me një shtresë llaq çimentoje deri në përgatitjen e sipërfaqës për ngjitjen e pllakave të qeramikës.	m ²	308.1	5.00	1,540.5 euro
6.4	Furnizimi me material dhe punimi i plafoneve nëpër tualete, me pllaka gjipsi t=12 mm dhe përpunimi i tij me glet masë deri në përpunimin përfundimtarë dhe përgatitje për lyerje.	m ²	25.8	12.00	309.6 euro
TOTAL: PUNËT E SUVATIMIT					5,163.30 euro

Tabela 20 - Paramasa për "punët e suvatimit" - kontrata e dytë

PUNËT E SUVATIMIT					
Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH euro	Çmimi total me TVSH euro
1.1	Furnizimi me material dhe suvatim i mureve të brendshme dhe tavanit për administratën dhe lokalet, me material të gatshëm për suvatim në trashësi 2.0 cm të punuar në dy shtresa. Shtresa e parë me sujavë të gatshme dhe shtresat e nevojshme, duke përfshirë Abrir 1 me ngjyrë të bardhë.	m ²	5,580.60	12.00 euro	66,967.20 euro
1.2	Furnizimi me material dhe suvatim i mureve të toaleteve dhe kuzhinës me material me material llaq çimentoje deri në përgatitjen e sipërfaqes për ngritjen e pllakave të qeramikës.	m ²	484.50	12.00 euro	5,814.00 euro
1.3	Furnizimi me material dhe punimi i plafoneve nëpër tualet, me pllaka gjipsi t=12 mm dhe përpunimi i tij me gled mase deri në përpunimin përfundimtar dhe përgatitje për lyerje.	m ²	113.60	17.00	1,931.20 euro
1.4	Furnizimi me material dhe suvatim i mureve të brendshme për pjesën e mbyllur të tregut, me material të gatshëm për suvatim në trashësi 2.0 të punuara në dy shtresa. Shtresa e parë me suvajtë të gatshëm ndërsa shtresa e dytë she shtresat e nevojshme duke u përfshirë Abrir 1 me ngjyrë të bardhë.	m ²	455.00	12.00	5,460.00 euro
1.5	Furnizimi me material dhe suvatim i shtyllave të objektit, me material të gatshëm për suvatim në trashësi 2.0 cm të punuar në dy shtresa. Shtresa e parë me suvajtë të gatshme dhe shtresat e nevojshme, duke përfshirë Abrir 1, lloji 1 ngjyra e ngjyrosjes sipas pjesës grafike (ngjyrë plastike, antracite).	m ²	460.80	13.00	5,990.40 euro
TOTAL POZICIONI 1:					86,162.80 euro

Sipas kësaj paramase, në kontratën e parë për furnizim dhe suvatim të mureve të brendshme për administratën janë cekur 224.1 m², ku për një m² është paguar 8 euro (tabela 19), ndërsa siç mund të vërehet në tabelën tjetër (tabela 20), sasia për këtë artikull është rritur në 5,580.6 m² me çmim prej 12 euro për një (1) m². Trendi i njëjtë ka vazhduar edhe në disa artikuj tjerë të kësaj kategorie.

Tabela 21 – Paramasa për “punët e nivelizimit“ – kontrata e parë

PUNËT E NIVELIZIMIT					
Poz. 7	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi në Euro	Çmimi total me të gjitha taksat e aplikuara në Euro
7.1	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit për të gjitha kthinat me dysheme finale nga Sika Comfortfloor dhe kompaktfloor -Estrihu 6 – 8 cm ² .	m ²	3,666.9	0.50 euro	1,833.40 euro
7.2	Furnizimi me material dhe nivelizimi me ramje 0.5 %, i nyjeve sanitare me beton të varfër duke përfshirë folinë, me trashësi min 8 cm.	m ²	25.8	9.00 euro	232.20 euro
7.3	Furnizimi me material dhe nivelizimi me ramje, i kioskave me beton të varfër duke përfshirë edhe folinë, me trashësi min 8 cm.	m ²	1,464.00	9.00 euro	13,176.00 euro
TOTAL: PUNËT E NIVELIZIMIT					15,241.63 euro

Tabela 22 - Paramasa për “punët e nivelizimit“ – kontrata e dytë

PUNIMET E NIVELIZIMIT					
Poz. 3	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
3.1	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit për të gjitha kthinat me dysheme finale nga betoni i varfër me të gjitha shtresat. Llogaritet tërë sip. E bazës – Estrihu 8 cm ² . Në çmim të parashihet folia edhe montimi i stiroporit t-3 cm.	m ²	2,793.00	8.00 euro	22,344.00 euro
3.2	Furnizimi me material dhe nivelizimi me ramje 0.5 % i nyjeve sanitare me beton duke përfshirë edhe folinë, me trashësi min 8 cm. Në çmim të parashihet edhe montimi i stiroporit t -3 cm.	m ²	44.08	12.00 euro	528.96 euro

3.3	Furnizimi me material dhe nivelizimi me ramje, i kioskave me beton duke përfshirë edhe folinë, duke përfshirë edhe folinë, me trashësi 8 cm. Në çmim të përfshihet edhe montimi i stiroporit t-3 cm.	m ²	882.00	8.00 euro	7,056.00 euro
-----	--	----------------	--------	-----------	---------------

TOTAL POZICIONI 3: 29,928.96 euro

Në paramasën e kontratës së pare (tabela 21), te pika 7.1. te kategoria “punët e nivelizimit” është kërkuar furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit për të gjitha kthinat me dysheme finale, ku për një (1) m² është dhënë çmimi 0.50 euro, çmim i cili në kontratën e dytë është kontraktuar me tetë (8) euro për m² (tabela 22), ashtu siç mund të vërehet në paramasën e kontratës së dytë. Porositja e pozicioneve të njëjta dhe rritja e çmimeve është përsëritur edhe për artikujt tjerë.

Tabela 23 - Paramasa për “punët e veshjes së dyshemesë dhe mureve” – kontrata e parë

PUNËT E MVESHJES SË DYSHEMESË DHE MUREVE					
Poz. 8	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
8.1	Furnizimi me material dhe shtrimi i dyshemeve tek pjesa e shitjes me kubza	m ²	3,666.9	15.00	55,002.86 €
8.2	Furnizimi me material dhe shtrimi i dyshemesë në të gjitha hapësirat e administratës me pllaka të qeramikës	m ²	381.8	20.00	7,635.60 €
8.3	Furnizimi me material dhe shtrimi i dyshemesë në pjesën e restaurantit mbi administratë dhe tualete me pllaka të qeramikës	m ²	190.4	20.00	3,808.00 €
8.4	Furnizimi me material dhe punimi i mureve në të gjitha kthinat e ëv-ve me pllaka të qeramikës	m ²	205.4	20.00	4,108.00 €
8.5	Furnizimi me material dhe ngjytja e qeramikës në murin e bufesë në mes elementeve të kuzhinës 1.0m	m ²	6.0	20.00	120.00 €
TOTAL: PUNËT E MVESHJES SË DYSHEMESË DHE MUREVE					70,674.46 €

Tabela 24 - Paramasa për “punët e veshjes së dyshemesë dhe mureve” – kontrata e dytë

PUNËT E MVESHJES SË DYSHEMESË DHE MUREVE					
Poz. 4	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
4.1	Furnizimi i transportit dhe punimi i pllakave nga betoni me strukturë të vrazhdë me trashësi min. 8cm (dim.60x30 cm ose 40x40) në tërë sipërfaqen e objektit. Në çmim të kalkulohen të gjitha materialet për montimin dhe funksionalizimi e tyre	m ²	3,425.00	15.00	51,375.00 €
4.2	Furnizimi me material dhe shtrimi i dyshemesë në të gjitha hapësirat e administratës me pllaka të qeramikës	m ²	312.76	28.00	8,757.28 €
4.3	Furnizimi me material dhe shtrimi i dyshemesë në pjesën e restaurantit mbi administratë dhe tualete me pllaka të qeramikës	m ²	270.40	28.00	7,571.20 €
4.4	Furnizimi me material dhe punimi i mureve në të gjitha kthinat e ëv-ve me pllaka të qeramikës	m ²	484.50	28.00	13,566.00 €
4.5	Furnizimi me material dhe ngjitja e qeramikës në murin e bufesë në mes të elementeve të kuzhinës 1.0 m	m ²	4.0	28.00	112.00 €
4.6	Sigurimi i materialit si dhe montimi i pllakave të granitit natyral nëpër shkallë me shkelëse 3 cm trashësi dhe ballore me trashësi 2 cm. Nivelizimi dhe montimi të jetë sipas normave dhe standardeve. Gjerësia e basamakut është 180 cm. Ngjyrën dhe llojin e zgjedhë projektuesi me investitorin. Llogaria për copë.	m ²	51.00	65.00	3,315.00 €
TOTAL POZICION 4					84,696.48 €

Edhe për “punët e veshjes së dyshemesë dhe mureve” ka pasur gjithashtu përsëritje, ku edhe në këtë paramasë janë vërejtur ngritje të çmimeve që janë paraqitur paramasat nga kontrata e parë dhe e dytë.

Tabela 25 - Paramasa për “punët në partner” – kontrata e parë

Poz.9	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi euro	Çmimi total me të gjitha taksat e aplikuara në euro
9.1	Furnizimi dhe montimi i kubezave të betonit duke i përfshirë edhe anësorët e betonit në perimetrin e të gjitha shtigjeve të shtruara me kubëza betoni, në pozicion përfshihet edhe zhavorri dhe shtresa mbrojtëse e hidroizolimit. Kubëzat e betonit me dim. 20x19x3cm Ngjyra parashihet nga arkitekti	m2	4,679.5	15.00	70,192.50 euro
9.2	Furnizimi, transporti dhe shtrimi i asfaltit beton ASB- 1L, t=7cm	m2	3,161.6	11.00	34,777.38 euro
9.3	Sjellja e materialit dhe mjellja e barit, përfshi para përpunimin dhe përgatitjen e tokës me planifikim, lavrim, bluarje, mjelljen e barit. Mirëmbajtja dhe ujitje deri në 30 ditë kalendarike	m2	931.8	6.00	5,590.92 euro
TOTALI: PUNËT NË PARTNER					110,560.80 euro

Tabela 26 - Paramasa për “punët në partner” – kontrata e dytë

Poz.5	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
5.1	Furnizimi dhe montimi i kubezave të betonit për pjesën e dëmtuar gjatë punimeve duke përfshirë edhe anësoret e betonit në perimetrin e të gjitha shtigjeve të shtruara me kubëza betoni në pozicion përfshihet edhe zhvaori dhe shtresa mbrojtëse hidroizolimit. Kubëzat e betonit me dim. 20x10x30 cm Ngjyra parashihet nga arkitekti	paushall	1.00	1,200.00	1,200.00 euro
5.2	Furnizimi, transporti dhe shtruarja e asfaltit beton për pjesën e dëmtuar të parkingut në fazën e parë AB – 11, t = 7 cm	paushall	1.00	1,250.00	1,250.00 euro
5.3	Sjellja e materialit dhe mjellja e barit, përfshi para përpunimin dhe përgatitjen e tokës me planifikim, lavrim, bluarje, mjelljen e barit, mirëmbajtje dhe ujitje deri 20 ditë kalendarike	m2	1,250.00	3.00	3,750.00 euro
TOTALI POZICION 5					6,200.00 euro

Te puna në “partner” te pozicioni që ka të bëjë me sjelljen e materialit dhe mbjelljen e barit, përfshi parapërpunimin dhe përgatitjen e tokës me planifikim, lëvrim, bluarjen, mbjelljen e barit, si dhe mirëmbajtjen dhe ujitjen për 30 ditë kalendarike, është pozicioni i cekur në të dy kontratat, madje herën e dytë janë shtuar rreth 300m² më shumë se herën e parë, vetëm se në këtë rast është ulur cmimi nga gjashtë (6) euro në 3 euro për m².

Tabela 27 - Paramasa për “punët e kulmit” – kontrata e parë

Poz. 12	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi në euro	Çmimi total
12.1	Furnizimi, bartja dhe përpunimi i mbulesës së kulmit nga materiali i plekiglasit	m2	3,769.30	7.00 euro	26,385.11 euro

Tabela 28 - Paramasa për “punët e kulmit” – kontrata e dytë

Poz.8	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
8.1	Furnizimi, bartja dhe punimi i mbulesës së kulmit nga materiali nga sendviq panel me trashësi 5 cm duke përfshirë edhe ankerat përforcues me bulonat për shtangim. Poashtu të parashihet hapësira për vendosjen e ndriqimit në stazat e komunikimit. Në llogari të hynë të gjitha elementet deri në funksionalizim. Ngjyra përcaktohet me mbikëqyrësin e projektit.	m2	5,660.00	25.00 euro	141,500.00
Totali pozicioni 8					141,500.00

Kulmi është një tjetër pozicion ku sasia e metrave katror është rritur gati dyfish, ndërsa çmimi është trefishuar, nga shtatë (7) euro për m², herën e dytë është kontraktuar me 25 euro për m², kulm i cili si shumica e pozicioneve më lart veç është dashur të kryhen në kontratën e parë.



Komuna e Podujevës

19. Renovimi i bibliotekës së qytetit

Komuna e Podujevës, në muajin mars të vitit 2021, ka shpallur tenderin me qëllim që të realizohet renovimi i bibliotekës së qytetit. Kjo bibliotekë ishte rrënuar në tetor të vitit 2018, ku pastaj në 2020 është vendosur në objektin e vjetër të komunës⁵².

Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 50,000.00 euro, derisa kontrata është lidhur me vlerë prej 39,969.85 euro. Siç shihet në tabelën në vazhdim, gjashtë operator ekonomik kanë aplikuar në këtë tender.

Tabela 29 - Operatorët ekonomik që ofertuan në këtë tender

Operatorët ekonomikë	Oferta
OE Detari Sh.P.K.	39,969.85 euro
OE Tribuna Sh.P.K.	37,869.99 euro
GOE Kompania Prishtina Sh.P.K. & Prishtina Group Sh.P.K.	46,444.00 euro
OE Arad 94 Sh.P.K.	48,948.48 euro
OE N.N. Global – ING	48,709.81 euro
GOE Tau –GeN- Injinerië & HALIT S. Rama B.I.	46,869.89 euro

⁵² Kallxo.com “Podujeva bëhet me Bibliotekë” : <https://bit.ly/3p6GcOi>

Kontrata është lidhur me datë 12 maj 2021 ndërmjet Komunës së Podujevës dhe “OE Detari Sh.P.K.”. Në bazë të analizimit të dokumenteve në Dosje të Tenderit, data e fillimit të punëve është caktuar pesë ditë nga data e nënshkrimit të kontratës dhe do të përfundojnë brenda 80 ditëve, pra duhet të përfundoj në muajin gusht 2021. Megjithatë, në bazë të planit dinamik të ofruar nga “Detari Sh.P.K”, vërehet se operatori ka planifikuar që punët të kryhen për 78 ditë, apo në fund të muajit korrik.

Nëse i referohemi faturave të siguruara nga Komuna e Podujevës, pas kërkesës për qasje në dokumente zyrtare⁵³, shohim se në total shpenzime për punët në këtë tender janë në vlerë prej 24,884.39 euro të ndara në tri fatura. Meqenëse nuk kemi të bëjmë me kontratë publike kornizë, ku lejohet +- 30% devijim nga vlera totale indikative, në këtë rast do të duhej të ekzekutohej në tërësi shumica e paraparë e kontratës. Dy faturat e fundit, të dorëzuara nga kompania fitues kanë datat 26 gusht 2021 dhe 5 tetor 2021. Pra, nëse marrim parasysh se këto fatura janë shtypur nga operatori fitues, kuptojmë se nuk është respektuar periudha kohore e përfundimit të punimeve të përcaktuara nga Komuna e Podujevës të Kushtet e Veçanta të kontratës, që ishte 80 ditë, e aq më pak afati prej 78 ditëve që e kishte propozuar vetë operatori fitues. Gjithashtu, neni 18 në Kushtet e Përgjithshme të kontratës (dokument i siguruar nga D+) përkufizon arsyet pse mund të shtyhet koha e ekzekutimit të kontratës. Mundësia për shtyrje të ekzekutimit të kontratës vije në shprehje vetëm nëse:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësoj .bligimet e veta ndaj kontratës;
- Forca madhore.

Sipas po të njëjtit nen, nëse shfaqen rrethana të tilla, operatori ekonomik duhet të njoftoj autoritetin kontraktues (në këtë rast Komunën e Podujevës) dhe i njëjti brenda afatit të përcaktuar në kontratë, duhet ta njoftoj operatorin ekonomik për lejimin e zgjatjes së afatit për ekzekutim të kontratës.

Pra, meqenëse kemi të bëjmë me mospërbushje të kontratës dhe mosrespektim të Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës, atëherë kontrata e tillë do të duhej të shkëputej.

Komuna e Podujevës në Dosjen e Tenderit, në mes të tjerash, ka kërkuar që OE të ofrojë listën e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Në këtë rast, Komuna e Podujevës nuk ka kërkuar specifikisht mjetet, një gjë e tillë është i është lënë në diskrecion operatorit ekonomik që të vendosë për pajisjet e nevojshme. OE “Detari Sh.P.K.” ka lidhur marrëveshje me kompaninë “Shkëlqimi Sh.P.K.”, përmes së cilës janë pajtuar se Detari Sh.P.K. do t'i shfrytëzojë mjetet e kësaj kompanie për qëllim të realizimit të këtij projekti. Në listë, “Detari Sh.P.K.” ka vendosur 24 mjete të nevojshme për realizim të tenderit. Mirëpo, që këto mjete të pranohen për kryerjen e punëve, të njëjtat do të duhet që të kenë regjistrim të vlefshëm, gjë që katër nga këto mjete të listuara janë me afat të skaduar të regjistrimit⁵⁴. Pra, meqenëse të gjitha këto mjete janë listuar në listën e mjeteve të nevojshme për punë, e katër nga to kanë regjistrim të skaduar, i bije se të njëjtat nuk mund të përdoren për kryerjen e këtyre punëve. Ky fakt do të duhej ta penalizonte kompaninë “Detari Sh.P.K.” gjatë vlerësimit të ofertave.

⁵³ Vlen të ceket që kërkesa për qasje është dërguar më 06 korrik 2021, ndërsa dokumentet janë dërguar më 22 nëntor 2021.

⁵⁴ Afat të skaduar të regjistrimit ka gjysmë rimorkio, regjistrimi i së cilës ka qenë valid deri më 08.10.2020, automjeti nga brendi Mercedes – Benz, dy dyer, 3.5 ton dhe më shumë, regjistrimi i këtij mjeri ka qenë valid deri më 14.08.2020. Deri më 26.06.2019, ka qenë valid regjistrimi për mjetin gjysmë rimorkio, nga brendi Renders. Pastaj, për mjetin kokë tërheqëse, dy dyer, nga prodhuesi MAN, regjistrimi ka qenë valid deri më 08.03.2019, gjithashtu, edhe për mjetin tjetër, po ashtu, kokë tërheqëse me dy dyer nga prodhuesi MAN, regjistrimi ka qenë valid deri më 08.10.2020.

20. Furnizimi dhe montimi i serrave për fermerë

Komuna e Podujevës, më 21 shkurt të vitit 2020, ka publikuar tenderin për furnizim dhe montim të serrave për fermerë me një buxhet të planifikuar prej 135,379.00 euro, ku 30% e kësaj shume do të vinte nga participimi i përfituesve. Në këtë tender me procedurë të hapur morën pjesë pesë operatorë ekonomik, teksa kontratën e fitoi Muharrem S.Rushiti B.I., si oferta me çmimin më të lirë në vlerë prej 113,428.68 euro.

Ky tender nuk është paraqitur me këtë emër nga Komuna e Podujevës në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin fiskal 2020⁵⁵, por në një sqarim të dhënë për D+⁵⁶, shefi i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Podujevës, ka deklaruar se është praktikë e komunës që ky tender të emërtohet si “Projekt për Perimkulturë”.

Tabela 30 – Çmimet e ofertave të operatorëve ekonomikë

Nr.	Operatori ekonomik	Çmimi
1	GO: PMC & Adri Zauna – Rrethoja	125,970.90 euro
2	Muharrem S.Rushiti B.I.	113,428.68 euro
3	Liria	121,771.00 euro
4	Euro Sera	115,227.00 euro
5	Berisha CONSTRUCTION	126,767.40 euro

Përveç OE “Muharrem S. Rushiti B.I.”, në këtë tender, kanë ofertuar edhe katër operatorë të tjerë ekonomik, tre prej të cilëve janë cilësuar si të përgjegjshëm dhe një si e papërgjegjshme, për mosplotësimin të kërkesave.

OE fitues ka bërë shkelje gjatë ekzekutimit të kontratës, duke mos respektuar afatin e prej 45 ditësh për furnizim. OE ishte i obliguar që brenda 45 ditëve të bënte furnizimin dhe montimin e 100 serrave, por brenda këtij afati kohor janë montuar vetëm 30 serra në vlerë prej 34,028.60 euro. 10 serra të tjera janë montuar jashtë afatit kohor të paraparë me kontratë, konkretisht më 1 shtator të vitit 2020⁵⁷.

Në këtë rast, për shkak të mosrespektimit të afateve kohore të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, janë shkaktuar vonesa te fermerët, të cilëve furnizimi me serra duhet t’u bëhet para stinës së verës, duke qenë se një pjesë e madhe e kulturave që ata kultivojnë kanë karakter sezonal.

Për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës, Komuna e Podujevës, në bazë të Kushteve të Përgjithshme të kontratës⁵⁸ me OE “Muharrem Rushiti B.I.”, ka mundur që pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve të tjera të kontratës, për secilën ditë që ka kaluar ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës, t’i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0.25% në ditë të vlerës së furnizimeve të padorëzuara deri në një maksimum prej 10% të vlerës totale të kontratës.

55 Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit për Komunën e Podujevës për vitin fiskal 2020: <https://bit.ly/32omcOe>

56 Shefi i zyrës së Prokurimit në Komunën e Podujevës, Rasim Fejza në komunikim direkt me D Plusin me datën 14 dhjetor, 2021. Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit për vitin Fiskal 2020: <https://bit.ly/3mi37Ez>

57 Fatura 43/20 e datës 01.09.2020 e Muharrem S Rushiti B.I. për KK Podujevë, Drejtoria e BPZHR.

58 Kontrata me numër 615-204-97-1-1, neni 16.

Një element tjetër problematik në këtë tender është edhe në Dosjen e Tenderit, te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë⁵⁹, ku AK ka kërkuar listën e pajisjeve dhe mjeteve të punës së domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt, duke mos specifikuar se për çfarë pajisje bëhet fjalë. OE i kontraktuar, në ofertë ka listuar katër mjete⁶⁰ me afat të skaduar të regjistrimit, të cilat nuk kanë të drejtë qarkullimi në trafik rrugor⁶¹ dhe aq më pak të kryejnë punë të kontraktuara.

Për punë të njëjtë, në vitin 2021, Komuna e Podujevës ka hapur sërish tender për “Furnizim dhe montim të serrave”, projekt ky i cili po ashtu nuk figuron në Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2021⁶². Për këtë aktivitet të prokurimit, Komuna e Podujevës kishte planifikuar 117,000.00 euro. Ky tender është zhvilluar përmes procedurës së hapur, ku ka pasur 26 OE të interesuar, por në këtë proces kanë marrë pjesë vetëm një GOE „Liria Sh.P.K. dhe Berisha CONSTRUCTION Sh.P.K.“, me të cilin komuna ka lidhur kontratë në vlerë prej 107,162.50 euro.

Tabela 31 – Çmimi i ofertës së grupit të operatorëve ekonomikë

Nr.	Operatori ekonomik	Çmimi
1	Liria Sh.P.K & Berisha CONSTRUCTION Sh.P.K	107,162.50 euro

Duke qenë ofertuesi i vetëm i përgjegjshëm, komuna ka nënshkruar kontratën me grupin e OE “Liria Sh.P.K. dhe Berisha CONSTRUCTION Sh.P.K.”. më 29 prill 2021, ku parashihej furnizimi dhe montimi i 250 serrave në Podujevë, në një afat prej 60 ditësh.

Komuna, më 21 qershor 2021, ka bërë shkëputjen e kontratës me GOE-në, me arsyetimin se nuk është bërë realizimi i furnizimeve sipas kushteve të kontratës, përkundër disa vërejtjeve me shkrim nga ana e AK-së, ku kërkohet specifikimi i një date për fillimin e punëve, duke përmendur edhe presionin nga ana e fermerëve për furnizim me serra⁶³.

GOE, vonesën e fillimit të punës sipas komunikimit zyrtar me AK, e arsyeton me problemet për sigurimin e hekurit (gypave të zinkuar të kërkuar sipas Dosjes së Tenderit), për shkak të ngritjes jonormale të çmimit të metaleve në treg. Komuna e Podujevës në këtë rast, me të drejtë, ka bërë shkëputjen e kontratës me GOE, duke konfiskuar kështu sigurimin e ekzekutimit sipas nenit 63 të LPP-së⁶⁴.

21. Riparimi i rrugëve të asfaltuara

Me kërkesën nga Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim⁶⁵, Komuna e Podujevës në qershor të vitit 2020, ka nisur procedurat e prokurimit për projektin “Riparimi i rrugëve të asfaltuara”, me arsyetimin se shumë rrugë të vjetra ishin të dëmtuara me gropa të rrezikshme, të cilat duhej riparuar. Ky projekt ishte planifikuar në

59 Kontrata nr. 615-204-9711 ndërmjet Komunës së Podujevës dhe Muharrem Rashiti B.I., neni 9.1 dhe 9.2.

60 Mjetet pa regjistrim valid të paraqitura nga Muharrem Rashiti B.I. janë: Rimorkio “Brenderup” me regjistrim të skaduar me datën 16.03.2019, kamioni “VW” me regjistrim të skaduar më datën 21.09.2019, kamionetë e tipit “VW” me regjistrim të skaduar më datën 16.05.2019, si dhe mjetin xhip “Nissan”, me regjistrim të skaduar më datën 29.10.2019.

61 Ligji për Automjete, neni 39, pika 1.

62 Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit për menaxherit të projektit nga Drejtoria e Shërbimeve në Komunën e Podujevës për vitin fiskal 2021: <https://bit.ly/3pggZRD>

63 Komunikim zyrtar përmes e-mail ndërmjet menaxherit të projektit nga Drejtoria e Shërbimeve në Komunën e Podujevës, Granit Hasani dhe OE më datën 21.05.2021.

64 Ligji për Prokurim Publik, neni 63 për konfiskim të sigurimit të ekzekutimit nga ana e Autoriteteve Kontraktuese.

65 Kërkesa nga Drejtoria për Shërbime Publike me numër protokollit 14-370/01-0026287/20, e bërë me datën 09.06.2020 për Departamentin e Prokurimit në Komunën e Podujevës.

Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit⁶⁶, teksa vlera e përgjithshme e parashikuar e kontratës ishte 185,700.00 euro, ku 95 mijë euro dedikoheshin për vitin 2020, ndërkohë pjesa tjetër për vitin 2021.

Për këtë tender, të zhvilluar me procedurë të hapur, kanë ofertuar 10 operatorë ekonomik. Oferta më e ulët ishte e OE “Eing COM Sh.P.K.”. në vlerë prej 18.50 euro, ndërkohë më e larta ishte nga OE “Toifor Sh.P.K.”. në vlerë prej 1,246.08 euro. Dallimi kaq i madh ndërmjet ofertës me çmimin më të ulët dhe ofertës me çmimin më të lartë, shpjegohet me plotësimin e gabuar të paramasës nga ana e OE, ku disa ofertues kishin paraqitur si çmim përfundimtar çmimin për njësi, e disa të tjerë çmimin total të ofertës.

Komuna e Podujevës, ka përdorur kriterin e tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, që në këtë rast ishte oferta e “OE EING COM”, me çmim 18.50 euro, kontratë e cila është lidhur në gusht të vitit 2020. Kujtojmë që funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është vlerësimi i ofertave, mirëpo kontrata lidhet për çmimet për njësi⁶⁷.

Tabela 32 – Çmimet e ofertave të operatorëve ekonomikë

Nr.	Tenderuesi	Çmimi
1	GOE INTEGRAL Sh.P.K., TALI Sh.P.K.	349,28 euro
2	GOE Burimi – E Sh.P.K., N.T.P. Keni P.N.	744,44 euro
3	EING COM Sh.P.K.	18.50 euro
4	K.N.P.Sh PAPANBURG & ADRIANI COMPANY Sh.P.K.	34.67 euro
5	N.N.T. ABC	32.49 euro
6	GOE Pro & Co Group SH.P.K, A-ABC Sh.P.K.	36.27 euro
7	Toifor Sh.P.K.	1,246.08 euro
8	EL-BAU Sh.P.K.	23.13 euro
9	GOE Nnsh VAAKAL, Company Murseli Sh.P.K	37.35 euro
10	Tahir Batatina B.I.	70,95 euro

Megjithatë, çmimi i ofertuar në pozicionin 1.3⁶⁸ që ka të bëjë me furnizimin, ngritjen dhe nivelizimin e kapakave të pusetave ekzistuese të kanalizimit atmosferik në kuotën e nivelit të rrugës nga “OE EING COM”, është shumë më i ulët sesa çmimet e operatorëve të tjerë.

Në fakt, çmimi i ofertuar prej tre (3) euro për njësi nga operatori fitues, është çmim jo normalisht i ulët sipas nenin 61 të LPP-së⁶⁹.

66 Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit i Komunës së Podujevës për vitin fiskal 2020: <https://bit.ly/3yNHq4a>

67 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, neni 28.14.

68 Çmimi i ofertuar i EING COM në pozicionin 1.3 të paramasës “Furnizimi, ngritja dhe nivelizimi i kapakëve të pusetave ekzistuese të kanalizimit atmosferik në kuotën e nivelit të rrugës.

69 Rregullat për Tenderë Jonormalisht të ulët nga KRPP: çmimi i ofertuar nga OE për këtë pozicion plotëson në mënyrë kumulative kushtet për tender jo

Tabela 33 – Çmimet e të gjithë ofertuesve për pozicionin 1.3

Çmimet për pozicionin 1.3 të paramasës nga operatorët e përgjegjshëm ekonomikë	Çmimi njësi
EING COM Sh.P.K.	3 euro
EL- BAU Sh.P.K.	20 euro
GOE INTEGRAL Sh.P.K, TALI Sh.P.K.	40 euro
N.N.T. ABC	45 euro
GOE VAAKAL, Company Murseli Sh.P.K.	45 euro
GOE Pro & Co Group Sh.P.K, A-ABC Sh.P.K.	50 euro
K.N.P.Sh PAPENBURG & ADRIANI COMPANY Sh.P.K.	80 euro
Toifor Sh.P.K.	130

Në këtë rast, AK do duhej që të kërkonte një deklaratë me shkrim nga OE EING COM, i cili do përfshinte një zbatim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit, si dhe do të duhej të jepte një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja “*Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët*”⁷⁰.

Pastaj, OE EING COM do duhej të paraqiste një shkresë shpjeguese për Komunën e Podujevës, nga e cila do të vendosej në qoftë se çmimi jonormalisht i ulët për pozicionin 1.3 është argumentuar apo jo. Në situata të tilla, në qoftë se OE arrin të argumentojë një çmim të tillë, AK do ta trajtojë njëjtë sikur tenderët e tjerë⁷¹, ndërsa në rastin kur sqarimi nuk mjafton, AK duhet ta refuzojë si ofertë dhe në përputhje me nenin 61 të LPP-së⁷² të njoftojë KRPP-në, duke përdorur formën standarde “*Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët*”, e atë brenda dy ditësh nga data e vendimit.

Duke mos iniciuar një shkresë të tillë dhe duke lidhur kontratë me “EING COM”, pavarësisht çmimit jo normalisht të ulët të paraqitur në ofertën e këtij OE, Komuna e Podujevës ka shkelur Ligjin e Prokurimit Publik⁷³ për trajtim në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik.

Sipas kontratës së lidhur ndërmjet Komunës së Podujevës dhe OE-së⁷⁴, sasitë e realizuara nuk mund të ndryshohen nga raportet sipas peshës së dhënë në DT. Gjatë realizimit të kësaj kontrate kornizë, është tejkaluar sasia në pozicionin numër 2.4 për 13,475.00 euro, apo 29%. Vlera totale e pozicionit nr.2.4 sipas kontratës është 46,425.00 euro, kurse në dy situacione, ky pozicion është paguar në vlerën 59,899.00 euro. Sipas menaxherit të kontratës, kjo ka ndodhur për shkak se janë riparuar disa rrugë që nuk kanë qenë të planifikuara të riparohen gjatë vitit 2020⁷⁵.

normalisht të ulët. Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm, është më shumë se 10% më i ulët se çmimi i tenderit të dytë më të ulët dhe janë dorëzuar më shumë se tre tenderë.

70 Rregullat për Tenderët Jonormalisht të Ulët nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, neni 4.2.

71 Rregullat për Tenderët Jonormalisht të Ulët nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, neni 4.6.1.

72 Ligji i Prokurimit Publik, neni 61 pika 3.

73 Ligji i Prokurimit Publik, neni 7.

74 Neni 3.1 i kontratës mes Komunës së Podujevës dhe OE.

75 Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2020,

22. Renovimi i hyrjeve dhe korridoreve të objekteve banesore në qytet

Për të bërë renovimin e hyrjeve dhe korridoreve të objekteve banesore në qytet, Komuna e Podujevës ka lidhur kontratë me grupin e operatorëve ekonomik "N.N. Zhvillimi & N.N.P". Vetoni. Vlera e parashikuar për këtë kontratë ishte 148,663.83 euro, ndërsa kontrata është lidhur në vlerë prej 96,931.69 euro.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar shtatë operatorë ekonomik. Në bazë të ofertave të dorëzuara, vërehet një ndryshim i madh ndërmjet çmimit të ofertave. P.sh dallimi ndërmjet ofertës më të lirë dhe asaj më të shtrenjtë është 36,338.14 euro.

Tabela 34 - Operatorët ekonomikë që ofertuan për këtë tender

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorëve Ekonomikë pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1	Starlin, Podujevë	119,908.86 euro
2	Blendi Color, Podujevë	125,593.86 euro
3	Kompania Prishtina, Prishtinë	124,224.00 euro
4	GO: Zhvillim & Vetoni, Podujevë	96,931.69 euro
5	Tribune, Prishtinë	119,726.81 euro
6	Cosult – ENG, Prishtinë	133,269.83 euro
7	Olti Trasiing, Prishtinë	98,443.51 euro

Raste të tilla tregojnë se komuna nuk ka analizuar mirë gjendjen faktike të tregut, duke mos planifikuar siç duhet aktivitetin e prokurimit. Në raste të tilla, ngritet dyshimi për marrëveshje paraprake ndërmjet autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik, duke ofertuar me çmim shumë më të ulët pavarësisht vlerës së parashikuar. Në këso situatash, kur kontraktohet me operatorin i cili ka ofertën dukshëm më të ulët se shumica e ofertave të tjera, shpeshherë rezultojnë që punët të mos kryhen në bazë të kërkesave të AK-së, por të ofrohen shërbime më të dobëta sesa janë paraparë. Siç edhe ka ndodhur me këtë tender, ku për pozicionin "Furnizim dhe montimi i dymëve" nuk ishte bërë me profil t=8cm dhe me xham treshtresor. Për këtë pozicion është vendosur xham dyshtresor dhe profil 4.5cm². Megjithatë probleme të tilla duhet të evidentohen nga menaxheri i kontratës, shpesh të njëjtat nuk raportohen në rast të shkeljeve nga OE. Për të arsyetuar këtë fakt, në rastin konkret, menaxheri ka aprovuar punimet, pavarësisht faktit se ato nuk kanë qenë në përputhje me kërkesat në kontratë.

Në dosjen e tenderit, Komuna e Podujevës ka paraqitur kërkesat e saj në mënyrë që përmes tyre të zgjedhë operatorin më të përshtatshëm për kryerjen e punëve të kërkuara me tender. AK në përcaktimin e kërkesës ka përdorur një gjuhë shumë të përgjithshme, p.sh. rasti me kërkesën që ka të bëjë me listën e mjeteve, ku komuna ka kërkuar një listë të mjeteve dhe pajisjeve që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, të cilat duhet të dëshmojnë me

anë të librezave, marrëveshjeve për qira, etj. Mirëpo, meqenëse komuna e ka të qartë se çfarë punësh do të kryhen duke u bazuar në paramasë, atëherë më mirë është të cekën pajisjet e mjetet e domosdoshme për përfundimin me sukses të projektit. Nëse një gjë e tillë do të paraqitet në DT, do të eliminoheshin situatat kur operatori ekonomik ofron çfarëdo lloj mjeti apo pajisjeje, pavarësisht faktit nëse ajo i duhet apo jo për këtë punë. Si pasojë e kësaj, operatori ekonomik fitues ka ofruar listën me disa pajisje, në mesin e tyre edhe mjete të rënda motorike, të cilat nuk shërbejnë për këtë tender.

23. Furnizimi me material anti-covid – dezinfektuesë për duar

Komuna e Podujevës, në fillim të vitit 2021, kishte hapur tender për furnizim me material anti-covid, me vlerë të parashikuar prej 10,000.00 euro. Për këtë tender kanë ofertuar 11 operatorë ekonomikë, ku oferta më e lirë për këtë tender ishte dhënë nga “Matkos Pharm Sh.P.K.” në vlerë prej 6,600.00 euro, ndërsa ajo më e larta ishte dhënë nga “Infinit Sh.P.K.” në vlerë prej 11,440.00 euro, ofertë e cila kishte kaluar vlerën e parashikuar të kontratës.

Tabela 35 - Lista e operatorëve ekonomikë që ofertuan për këtë tender

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorëve Ekonomikë pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1	Selver Shala B.I Prizren	8,800.00 euro
2	IDEA EET, Suharekë	7,865.00 euro
3	KORAL & KRAS, Prishtinë	9,955.99 euro
4	Troja, Prishtinë	8,690.00 euro
5	Europrint Group, Prishtinë	9,955.44 euro
6	Blendi O.P, Prishtinë	9,925.00 euro
7	Kiga, Fushë Kosovë	9,295.00 euro
8	Teknika, Prishtinë	8,690.00 euro
9	Matkos Phram, Prishtinë	6,600.00 euro
10	Infinit, Prishtinë	11,440.00 euro
11	AWA, Prishtinë	10,450.00 euro

Tenderi i është dhënë operatorit “IDEA EET Sh.P.K.” në vlerë prej 7,865.00 euro, me ç’rast kontrata ishte nënshkruar më 30 prill 2021. Ndërsa, “OE Matkos Pharm Sh.P.K.” është eliminuar meqë nuk kishte sjellë sigurimin e tenderit.

Komuna e Podujevës nuk ka paraqitur asnjë kërkesë në DT lidhur me kapacitetin ekonomik, teknik dhe profesional, kështu duke i hapur rrugë të gjithë OE-ve të aplikojnë për këtë tender, pavarësisht faktit nëse ato kompani janë të specializuara në kryerjen e këtyre punëve apo jo. Mirëpo, meqenëse kemi të bëjmë me produkte që kanë ndikim

direkt në shëndetin e njeriut, komuna do të duhej që së paku të kërkojë dëshmi se operatori ekonomik fitues mund ta realizojë këtë furnizim pa ndonjë problem përmes referencave e kontratave të realizuara më parë. Kriteri i vetëm për të marrë tenderin ka qenë oferta me çmimin më të lirë.

OE i kontraktuar, pavarësisht se ka qenë i përgjegjshëm me ofertën më të lirë, veprimtaria e këtij biznesi nuk lidhet me furnizime të produkteve të tilla. Sipas ARBK, operatori “IDEA EET Sh.P.K.”, e themeluar në vitin 2020, si aktivitet primarë ka marrjen dhe dhënien me qira të veturave dhe automjeteve të lehta motorike. Ndërsa, aktivitet sekondar ka transportin rrugor të mallrave. Megjithatë, kjo kompani nuk merret me produkte medicinale, atëherë do të duhej të ofronte ndonjë dëshmi për origjinën e produktit ashtu siç kërkohet edhe me nenin 3 të kontratës. Nga dokumentacioni që D+ ka siguruar nga komuna, shihet se një dokument i tillë nuk është dorëzuar.

Komuna e Podujevës ka kërkuar që të bëhet furnizimi në sasi totale prej 5,500 litrave me dezinfektuesë me bazë alkooli, min. 70%, paketimi 5 litra deri në 10 litra. Në raste të tilla, ku AK nuk precizon sasinë e paketimit të artikullit mund të shkaktohen probleme të shumta, e veçanërisht në dorëzimin e ofertave nga OE. Me këtë përshkrim, disa OE mund të ofertojnë me sasi 10 litërsh, ndërsa të tjerë për 5 litërshin, element i cili do të bënte diferencimin automatik të ofertave.

Duke u bazuar në faturat e dorëzuara nga operatori ekonomik fitues, kuptojmë se një furnizim i tillë është realizuar brenda periudhës së paraparë kohore. Mirëpo, është shumë e paqartë nëse operatori ekonomik ka furnizuar me dezinfektuesin 5 litërsh apo 10 litra. Gjithsej, çmimi prej 1.43 eurove për dezinfektues me paketim prej 5 litrave është shumë i ulët, e aq më shumë për atë 10 litra. Sa i përket çmimeve në treg, me 1.43 euro më së shumti mund të blihet dezinfektuesi prej 500ml.

Tabela 36 - Paramasa dhe çmimi i blerjes së produktit

Nr.	Emërtimi i materialit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	DEZINFEKTUES TË DUARVE ME BAZË TË ALKOOLIT (Minimum 70%), paketimi 5 litra deri 10 litra, i lëngshëm	Litra	5,500	1.43	7,865.00
Totali					7,865.00

Nëse komuna praktikon këtë mënyrë të porositjes së artikujve, sidomos duke mos specifikuar saktë peshën, atëherë vazhdimisht do t'i ekspozohet mundësisë që një furnizim i tillë të mos realizohet sipas kërkesave të komunës dhe të dështojë qëllimi i AK-së.

24. Meremetimi i hyrjeve të objekteve banesore

Komuna e Podujevës për meremetimin e hyrjeve të objekteve banesore, ka paraparë të ndajë 200,000.00 euro për vitin 2021. Ky tender është zhvilluar përmes procedurës së hapur dhe kontratës së tipit kornizë, e cila ka kohëzgjatje 18 muajshe. Nga totali i vlerës së parashikuar për këtë kontratë, komuna ka planifikuar për vitin 2021 të shpenzohen 80,000.00 euro, ndërsa për vitin 2022, 120,000.00 euro.

Për këtë tender kanë ofertuar dhjetë operatorë ekonomikë. Ashtu siç edhe është kontrata, pra kontratë kornizë, ashtu edhe operatorët ekonomikë kanë ofertuar me çmimet e peshuara nga oferta e tyre. Oferta më e lirë, sipas çmimit të peshuar, është 94.22 euro nga OE “OK Construction Sh.P.K.”, ndërsa ajo më e shtrenjta është 406.13 euro

nga OE “N.P.Sh. Starling”. Tenderi i është dhënë operatorit ekonomik më të lirë, OE “OK Construction Sh.P.K.”, me të cilin komuna ka nënshkruar kontratë më 22 korrik 2021.

Tabela 37- Operatorët ekonomikë që kanë ofertuar për këtë tender, me çmime të peshuara

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorëve Ekonomikë pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1	OK Construction Sh.P.K. – Prishtinë	94.22 euro (çmim i peshuar)
2	Ulpiana Group Sh.P.K. – Prishtinë	103.20euro (çmim i peshuar)
3	NBT – ING, SHPK – SHIROKË	125.10 euro (çmim i peshuar)
4	GOE NTPSH LIMIT L&B Sh.P.K. Sfinga SH.P.K. Prizren	129.56 euro (çmim i peshuar)
5	GOE NN ZHVILLIMI NNP VETONI – Podujevë	153.20 euro (çmim i peshuar)
6	GOE Prishtina Sh.P.K. & Prishtina Group Sh.P.K – Prishtinë	159.34 euro (çmim i peshuar)
7	Limit Project Sh.P.K – Podujevë	190.50 euro (çmim i peshuar)
8	Eing COM Sh.P.K – Podujevë	197.78 euro (çmim i peshuar)
9	NN Blendi Color – Podujevë	358.37 euro (çmim i peshuar)
10	NTSH Starlin – Podujevë	406,13 euro (çmim i peshuar)

Në Dosje të Tenderit, komuna ka kërkuar që të plotësohen disa kërkesa të përshtatshmërisë dhe të vërtetohen kapacitetet ekonomike, teknike e profesionale të operatorit ekonomik. Te kapacitetet ekonomike e financiare, komuna ka kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë se qarkullimi financiar për tre vitet e fundit është jo më pak se 380,000.00 euro. Duke pasur parasysh që afati i fundit i dorëzimit të ofertave ka qenë 31 maj 2021, nënkupton se dëshmitë duhet të ofrohen nga maji 2018 deri në maj të vitit 2021. Në ofertën e tij, OE fitues ka dorëzuar dëshmi për qarkullimin financiar nga viti 2016 deri në vitin 2020, që së bashku mbulojnë shumën 501,173.3 euro. Mirëpo, qarkullimi i vitit 2016 dhe 2017 nuk duhet të merret parasysh. Kjo nënkupton se OE fitues nuk e plotëson këtë kriter, që e bën të papërgjegjshëm, rrjedhimisht do duhej të refuzohej.

Gjithashtu, komuna përmes Dosjes së Tenderit ka kërkuar nga OE që të ofrojë dëshmi se ka punëtorë të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, duke kërkuar minimum 20 punëtorë. Po ashtu, komuna ka kërkuar të ofrohet dëshmi për angazhimin e menaxherit të projektit, inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, dhe një inxhinier të diplomuar apo master i arkitekturës. Për të vërtetuar se OE i ka këta punëtorë, komuna ka kërkuar që të ofrohet si dëshmi kontrata e punës me punëdhënësin. OE fitues ka listuar 21 punëtorë, në mesin e tyre edhe drejtorin e kompanisë, mirëpo ka ofruar kontratat të punës vetëm për 17 punëtorë dhe një kontratë për angazhim të inxhinierit të ndërtimtarisë. Pra, për 18 punëtorë duke përfshirë edhe pronarin, gjithsej 19. Po ashtu, operatori nuk ka dëshmuar se ka edhe inxhinierin e arkitekturës, siç është kërkuar me DT. Në një situatë të tillë, komuna do të duhej ta refuzonte ofertën dhe ta konsideronte operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Përfundime dhe rekomandime

Sipas elaborimit më sipër, mund të nxjerrën disa përfundime si në vijim:

- Komunitat subjekt i këtij raporti kanë përdorur në masë të madhe procedurën e negociuar të prokurimit publik nën arsyetimin e emergjencës të shkaktuar nga COVID-19. Kjo procedurë ka mundur të arsyetohet në fillimin të pandemisë (pranverë 2020), por jo edhe gjatë tërë vitit 2020 dhe 2021, në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik (LPP);
- Komunitat gjatë përdorimit të procedurës së negociuar kanë ftuar numër të vogël të operatorëve ekonomikë për të ofertuar në tender. Kjo ka kufizuar konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë dhe ka rezultuar në kurdisje të tenderit nga ana e komunave, po ashtu në kundërshtim me LPP;
- Komunitat nuk kanë diskualifikuar operatorët ekonomikë të cilët kanë dorëzuar dokumente të pavlefshme në procesin e tenderimit, por të njëjtit operatorë janë shpërblyer me kontratë në kundërshtim me LPP;
- Menaxherët e kontratave të komunave subjekt në këtë raport nuk kanë marrë asnjë masë duke përfshirë edhe anulimin e kontratës edhe pse operatorët ekonomikë janë treguar të papërgjegjshëm duke vonuar zbatimin e kontratës;
- Komunitat subjekt në këtë raport kanë vazhduar të kërkojnë prej operatorëve ekonomikë të dorëzojnë certifikata specifike jashtë natyrës së punës që është kërkuar të kryhet, e po ashtu edhe standarde të vendeve specifike në kundërshtim me LPP;

Rekomandimet për komunitat përkatëse janë si në vijim:

Rekomandime të përgjithshme:

- Institucionet publike të evitojnë procedurat e negociuara në kundërshtim me LPP-në. Mirëpo, në rast të përdorimit të procedurës së negociuar sipas LPP-së, institucionet publike duhet të ftojnë numër më të madh të operatorëve ekonomikë, për ta rritur kështu konkurrencën;
- Institucionet publike të investojnë në përmirësimin e menaxhimit të kontratave, pasi është problem madhor i pothuajse të gjithë operatorëve ekonomikë;
- Institucionet publike t'i shfrytëzojnë mjetet për ndëshkimin e OE-ve joserioze, të cilët çalojnë në zbatimin e kontratës;
- Institucionet publike t'i evitojnë kërkesat diskriminuese, sidomos të ISO-ve jashtë funksionit, dhe të atyre që nuk kanë të bëjnë me lëndën e tenderit të shpallur.

Rekomandime të veçanta:

Komuna e Gjakovës:

- Duhet ta ketë parasysh që të mos parashtrojë kritere diskriminuese në DT, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca;
- Në çdo rast duhet të bëjë konfiskimin e sigurimit të tenderit dhe për operatorin ekonomik përkatës të bëjnë kërkesë për vendosjen në Listë të Zezë, ashtu siç e parasheh ligji;
- Duhet të vendosë saktë dhe qartë kërkesat që OE-të duhet t'i plotësojnë, në mënyrë që të eliminohen problemet e mëtejshme.

Komuna e Gjilanit:

- Të ftojë më shumë OE në procedura të negociuara, pasi në këtë mënyrë rritet konkurrenca dhe si rezultat ka efekt edhe në uljen e çmimeve;
- Në kontratat kornizë që zgjasin më shumë se një vit, vlera të përcaktohet në totalin e kontratës, e jo vetëm për një vit;
- Të caktojë afat të vlefshmërisë të tenderit siç e parasheh ligji, sipas vlerës së kontratës;
- Të bëjë menaxhim më të mirë të kontratave dhe shqiptim të penaltive dhe shkëputje të kontratave në rast të zbatimit të dobët.

Komuna e Podujevës:

- Duhet të marrë masa të nevojshme ndaj operatorit ekonomik që nuk i përmbahet kushteve të kontratës, në mënyrë që kjo të ndikojë në disiplinimin e operatorëve tjerë ekonomikë;
- Duhet të ketë kujdes të shtuar në hartimin e paramasës dhe pozicioneve, në mënyrë që të eliminoj konfuzionin mes operatorëve ekonomik dhe të minimizoj mundësinë për dështim të realizimit të kontratës;
- Duhet të përcaktojë saktë kërkesat në DT, sidomos te mjetet e punës dhe të kërkojë vetëm ato mjete të nevojshme për kryerjen e punëve.

Komuna e Mitrovicës së Jugut:

- Ta evitojë përcaktimin e numrit të kontratave të realizuara si dëshmi për punët e kryera në tri vitet e fundit, por të caktohet vetëm vlera e tyre;
- Të mos kryhej asnjë pagesë pa filluar zbatimin e kontratës, përveç nëse në kontratë parashihet si avans;
- Të bëjë planifikim më të mirë dhe studim të tregut, në mënyrë që të mos ketë tejkalim të vlerës së parashikuar, përveç rasteve kur një gjë e tillë nuk ka qenë e mundur;
- Në çdo rast kur ka çmime jonormalisht të ulëta, të kërkojë sqarime shpesh përkitazi me dispozitat e LPP-së;
- Të mos i ngatërrojë kriteret e dhënies së tenderit, d.m.th. të mos përdoren në të njëjtin tender, kriteri me çmimin më të lirë dhe kriteri ekonomikisht më i favorshëm;
- Ta evitojë përmendjen e markave (brendeve), pasi në mënyrë të drejtpërdrejt dëmtohet konkurrenca;
- Të mos e shkurtojë afatin e dorëzimit të ofertave në kundërshtim me LPP-në;
- T'i refuzojë ofertat që nuk i kanë dorëzuar referencat në vlerën e paraparë në DT dhe në të njëjtën kohë t'i refuzojë ato referenca që janë dorëzuar për kontrata ende të papërfunduar.



Funded by
the European Union



Democracy
Plus